



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE, TURIZMIT DHE TRANSPORTIT

Nr. 3250/prot.

B.Curri, më 01. 08. 2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____. 2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE BASHKIA TROPOJË"

Këshilli i Bashkisë Tropojë, bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 12 dhe neni 13 (i ndryshuar); Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore (i ndryshuar); Ligjin nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", (i ndryshuar); Ligjin nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; Ligjin nr.8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave"; VKM nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035"; VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"; VKM nr.319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"; VKM nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve"; VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"; VKM nr. 452, datë 11.07.2012 "Për landfillin e mbetjeve" (i ndryshuar); Urdhër nr.120, datë 18.07.2025 "Për caktimin e komisionit për hartimin e Planit Menaxhimit të Mbetjeve Urbane 2025-2030".

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Tropojë 2025-2030 sipas dokumentit të planit të bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Tropojë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika (i ndryshuar).


Grupi punës S.Murataj
Ervis Mahmutaj
Time Kucana

Ligjshmëria: F.Vatoci

KRYETARI
Rexhe Byberi

ME URDHËR DHE POROSI

Zv/Kryetare
Zyra Islamaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE, TURIZMIT DHE TRANSPORTIT

Nr. 3250/prot.
12

B. Curri, më 01. 08. 2025

RELACION

PËR "PROJEKTPLANIN VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË BASHKISË TROPOJË"

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-vendimi **"Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkia Tropojë"** të cilin e paraqesim për miratim nga ana juaj është hartuar nga administrata e bashkisë Tropojë.

Ky projekt-vendim është hartuar edhe bazuar ne dispozitat ligjore të cituata si: Në përmbushje të kërkesës së Ligjit Nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" neni 12 dhe neni 13 (i ndryshuar); Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar); Ligjit Nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligjit Nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", (i ndryshuar); Ligjit nr.8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave"; VKM Nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035"; VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"; në funksion dhe në përmbushje të kuadrit ligjor mjedisor, VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.333, datë 26.01.2011, "Për administrimin e vend depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane; , VKM nr.1189, datë 18.11.2009, "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit (i ndryshuar)", VKM nr.319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve".

Gjittashtu i është referuar dhe Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 45 (i ndryshuar); Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në

Republikën e Shqipërisë” neni 44 (i ndryshuar); dhe me Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tropojë nr.210 datë 18.07.2025 për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane, i ndryshuar, paraqesim relacionin si më poshtë:

Me qëllim që nga ana juaj të bëhet një vlerësim i saktë i këtij projektvendimi për Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve po ju paraqesim shkurtimisht disa nga treguesit të cilët janë marrë parasysh në hartimin e këtij plani, si më poshtë:

Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioritetëve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Kjo metodologji propozon 5 hapa në shkallë, duke filluar nga më baziku deri tek ai më optimali, të cilët përcaktojnë standardin minimal të ofrimit të shërbimit:

- I. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025-2030
- II. Zgjerimi i shërbimit në 100% në zonën urbane dhe 90% në zonën rurale gjatë periudhës 2025 – 2030
- III. Rritja e shkallës së grumbullimit të tarifës në masën 100% për bizneset, 90% për banorët dhe 100% për institucionet përgjatë periudhës 2025-2030.
- IV. Rritja e mbulimit të koston operacionale me 10% çdo vit, gjatë periudhës 2025-2030.

Propozimi i skenarëve për organizimin e shërbimit në Bashkinë Tropojë, do të bëhet bazuar në objektivin kryesorë të bashkisë për të ndërmarrë hapat për arritjen e standardit minimal të formimit të shërbimit. Të dy skenarët do të synojnë, në nivele të caktuara, ofrimin e një shërbimi me standarde sa më të larta, me kosto optimale dhe të përballueshme nga taksa paguesit, për të synuar mbulimin e plotë të koston së shërbimit, bashkia propozon dy skenarë të mundshëm për ofrimin e shërbimit. Qëllimi i bashkisë është të rrisë cilësinë e shërbimit në sajë të përmirësimit të infrastrukturës dhe diversifikimin e shërbimeve që ajo ofron. Për secilin nga skenarët është bërë llogaritja e koston sipas modelit të miratuar me VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”. Formulimi i skenarëve është realizuar bazuar në konsideratat më poshtë:

Skenari bazë

Grumbullim i mbetjeve miks në 90% të zonës urbane dhe 70% zonës rurale

Transportim i tyre me mjete teknologjike.

Grupet e interesit patën mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim

Pjesëmarrës: Të pranishmit treguan shumë interes dhe u përfshinë në mënyrë aktive gjatë prezantimit të analizës së situatës aktuale të shërbimeve në Bashkinë e Tropojës. Po kështu prezantimet e objektivave strategjike e specifike, treguesve matës dhe masave të Planit u ndoqën me interes dhe u shoqëruan me komente e sugjerime, të cilat janë marrë parasysh gjatë rishikimit të projektplanit.

Nga sa parashtruam më lart, nëpërmjet këtij relacioni, ftojmë këshilltarët ta votojnë këtë projektvendim.

Kjo do të shërbejë për plotësimin e detyrimit ligjor që ka administrata e bashkisë Tropojë si organ i Qeverisjes Vendore, por edhe një angazhim më të lartë të administratës së bashkisë për zbatim dhe monitorim të objektivave në fushën e mbetjeve.

Grupi punës S.Murataj
E. Mahmutaj
T.Kucana

KRYETARI
Rexhe Byberi

ME URDHËR DHE POROSI

Zv/Kryetare
Zyra Islamaj

Nr 3250/Prot

Date 01.082025



**Hartuar nga
Bashkia Tropojë
me ndihmën e
Bashkive të Forta**

Hartoi:

Grupi punës S.Murataj

Ervis Mahmutaj

Time Kucana

KRYETARI
Rexhe Byberi

**ME URDHËR DHE
POROSI**

Zv/Kryetare

Zyra Islamaj

PLANI MENAXHIMIT TE MBETJEVE URBANE 2025-2030



PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	5
1 HYRJE	6-7
1.1 Nevoja për hartimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane	8
1.1.1 Plani përfshin:	8-9
1.2 Hartimi i Planit në Bashkinë Tropojë	11-12
2 POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETJEVE	12
2.1 Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve	12-13
3 ASPEKTE INSTITUCIONALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	13
3.1 Organizimi në nivel qendror	13-15
3.2 Organizimi në nivel lokal	15-16
3.3 Informacion përmbledhes mbi legjislacionin.....	17-19
4 PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME	19
4.1 Të dhëna gjeografike dhe demografike	19-20
4.1.1 Pozita Gjeografike	20-22
4.2 Demografia.....	22-24
4.3 Aspekte ekonomike në Bashkinë Tropojë	24-29
4.4 Analiza e gjendjes për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2023 - 2025	30-32
4.5 Burimet njerëzore	33
4.6 Mjetet	34
4.6.1 Kontenierë	34-35
4.6.2 Kamionë	36
4.7 Mbledhja dhe transporti i mbetjeve	37-39

4.8 Llojet e mbetjeve që identifikohen në bashkinë e Tropojës janë:	39-42
4.8.1 Mbetjet në ujëra sipërfaqësor (plastika)	42-43
4.9 Problemet me menaxhimin e mbetjeve	43-49
4.10 Shërbimi i pastrimit të rrugëve dhe shesheve	50
5. ANALIZA E FINANCIARE E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE	51
6. RICIKLIMI DHE KOMPOSTIMI	52
6.1 Menaxhimi i mbetjeve përmes edukimit në shkollë	53-54
6.2 Riciklimi si pjesë e rëndësishme e zgjidhjes	54
6.3 Përfitimi nga riciklimi	55
7. INDIKATORËT E PERFORMANCËS	56-58
8. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE	59
8.1 Objektivat	59
8.2 Skenarët e ofrimit të shërbimit	59-60
9 PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE.....	60
9.1 Vizioni	60
9.2 Objektivat	61
9.3 Rryma e mbetjeve, objekti i planit	61-62
9.4 Grumbullimi, transporti i mbetjeve	62-64
9.5 Menaxhimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore	65
10 SKENARËT E MUNDSHËM NE MENAXHIMIN E MBETJEVE.....	66-67
11 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	68
11.1 Rregullorja vendore	68-69
11.2 Zbatimi dhe sanksionet	69
12 NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK	69-71
12.1 Fushata e informimit në Bashkinë Tropojë gjatë hartimit të planit	71-74

13 PLAN VEPRIMI	75
13.1 Komponenti: Kuadri ligjor dhe institucional	75-77
13.2 Komponenti: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve dhe Pastrimi i Rrugëve	78-79
13.3 Komponenti: Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve	80
13.4 Komponenti: Ndarja dhe Riciklimi i mbetjeve	81-82
13.5 Komponenti: Aspektet Financiare.....	83-84
13.6 Komponenti: Ndërgjegjësimi Publik dhe Edukimi	85-86
14 RISHIKIMI I PLANIT	87
14.1 Monitorimi	87
14.2 Si kryhet monitorimi dhe vlerësimi	88

SHKURTIMET

- **AKM:** Agjensia Kombëtare e Mjedisit
- **ARM:** Agjensia Rajonale e Mjedisit
- **BE:** Bashkimi European
- **ISHMPU:** Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujrave
- **ISHSH:** Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë
- **MB:** Mbetjet nga Bizneset
- **MBZHR:** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- **MF:** Mbetjet nga Familjet
- **MIE:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- **MTM:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- **NJA:** Njësi Administrative
- **NJQV:** Njësi Qëndrore Vendore
- **OJF:** Organizata Jo Fitimprurëse
- **PLMIMNU:** Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane
- **PKMM:** Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve
- **PGM:** Pikë Grumbullimi Mbetjesh
- **PPP:** Partneritet Publik Privat
- **SKM:** Strategjia Kombëtare e Mbetjeve
- **VKM:** Vendim i Këshillit të Ministrave
- **ZAM:** Zona e Administrimit të Mbetjeve

1 HYRJJE

Bashkia Tropojë shtrihet në veri të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Tropojë. Ka një sipërfaqe prej rreth 1,043 km² dhe përbëhet nga 7 njësi administrative: Tropojë, Bujan, Bytyç, Lekbibaj, Margegaj, Llugaj dhe Tropojë e Vjetër. Popullsia rezidente është rreth 20,000 banorë, me përqendrim më të madh në qytetin e Bajram Currit dhe në disa qendra të banuara të njërive administrative.

Territori i Bashkisë karakterizohet nga një reliev malor, me përhapje të gjerë të zonave rurale, gjë që krijon sfida logjistike për ofrimin e shërbimeve të rregullta të pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve.

Shërbimi i pastrimit ofrohet në mënyrë të organizuar në qytetin e Bajram Currit dhe në disa fshatra kryesorë, ndërkohë që në pjesën më të madhe të zonave rurale mungon një shërbim i rregullt për grumbullimin e mbetjeve. Mbetjet mbledhen kryesisht nga punonjësit e ndërmarrjes së shërbimeve publike me mjete të Bashkisë.

Në qytet përdoren kontenierë metalikë dhe plastikë për mbledhjen e mbetjeve të përziera, të cilat më pas transportohen në vendgrumbullimin e përkohshëm në periferi të qytetit.

b) Ndarja në burim dhe riciklimi

Aktualisht mungon një sistem funksional për ndarjen në burim të mbetjeve (organike, plastike, letër, qelq, etj.). Niveli i riciklimit është minimal, pasi të gjitha mbetjet trajtohen si mbetje të përziera. Një pjesë shumë e vogël e mbetjeve, kryesisht kanaçet dhe shishet plastike, riciklohen në mënyrë spontane nga individë të veçantë për qëllime ekonomike.

c) Menaxhimi i mbetjeve inerte dhe organike

Mbetjet inerte nga ndërtimet ose prishjet e objekteve nuk menaxhohen në mënyrë të organizuar. Ato shpesh përfundojnë në zona të papërcaktuara ose lumenj. Po ashtu, mungojnë struktura për përpunimin e mbetjeve organike, që përbëjnë një përqindje të madhe të mbetjeve të prodhuara në territorin rural.

d) Vatrast e mbetjeve dhe ndotja mjedisore

Në disa zona rurale dhe pranë rrugëve dytësore janë krijuar vatra të përhershme të mbetjeve të hedhura në mënyrë të pakontrolluar. Mungesa e monitorimit dhe e ndërgjegjësimit ka bërë që ndotja e mjedisit të jetë një problem i përhapur, veçanërisht në afërsi të lumenjve, burimeve ujore dhe vendeve turistike.

e) Infrastruktura dhe kapacitetet njerëzore

Bashkia Tropojë përballlet me mungesë mjetesh moderne për grumbullim dhe transport. Flota e automjeteve është e vjetër dhe shpesh jo funksionale. Po ashtu, numri i punonjësve në sektorin e pastrimit nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjithë territorin në mënyrë efektive.

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNGU) është një dokument strategjik dhe operacional që synon përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor. Ky plan hartohet në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe politikat e zhvillimit të qëndrueshëm, me qëllim garantimin e një mjedisi të pastër, mbrojtjen e shëndetit publik dhe promovimin e ekonomisë qarkulluese.

PLMIMNGU adreson të gjitha hallkat e ciklit të mbetjeve - nga parandalimi, grumbullimi, transporti dhe trajtimi, deri tek riciklimi dhe depozitimi final - në mënyrë të integruar dhe efikase. Nëpërmjet këtij plani, njësia vendore përcakton objektivat afatshkurtra dhe afatgjata, identifikon burimet dhe nevojat për investime, si dhe angazhon komunitetin dhe aktorët lokalë në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve.

Në këtë kontekst, PLMIMNGU përbën një instrument të domosdoshëm për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ky plan është një instrument që ndihmon Bashkinë Tropojë të përmbushë kërkesat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizojë shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm për komunitetin, gjithashtu ka si qëllim përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e ndërgjegjësisë së qytetarëve, dhe nxitjen e praktikave të riciklimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të mbetjeve.

Në thelb, ky plan:

- Përfshin një analizë të situatës aktuale të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Tropojë dhe identifikon problemet dhe mundësitë për përmirësim.
- Përcakton objektiva dhe qëllime strategjike që duhet të arrihen në periudha të caktuara kohore.
- Propozon masa dhe aktivitete konkrete për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë investime në infrastrukturë, edukim të qytetarëve dhe zhvillim të kapaciteteve institucionale.
- Siguron një kornizë për monitorim dhe raportim, për të vlerësuar ecurinë e implementimit të planit dhe për të marrë masa korrigjuese nëse është e nevojshme.

1.1 Menaxhimi i integruar i mbetjeve përbën një sfidë kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm të çdo njësie vendore. Bashkia Tropojë, si një njësi administrative me potencial të madh natyror dhe turistik, përballlet me nevojën për të ndërtuar një sistem efikas të menaxhimit të mbetjeve, i cili mbështet ruajtjen e mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët dhe përshtatjen me kuadrin ligjor kombëtar dhe direktivat e BE-së.

Ky plan për periudhën 2025–2030 synon të vendosë një kuadër strategjik dhe operacional për menaxhimin e mbetjeve urbane, përfshirë mbetjet e ngurta, mbetjet inerte, mbetjet organike, si dhe ndarjen në burim dhe riciklimin. Hartimi i këtij dokumenti bazohet në parimet e ekonomisë qarkulluese, mbrojtjes së burimeve natyrore, dhe përfshirjes së komunitetit në procesin e menaxhimit të mbetjeve.

PMIMNGU për Bashkinë Tropojë përcakton mënyrën sipas së cilës do të ushtrohet dhe shtrihet funksioni i menaxhimit të mbetjeve në këtë bashki.

PMIMNGU ofron zgjidhje lokale gjerësisht të pranuar dhe një kuadër të miratuar pune, sipas të cilit mund të merren vendime lidhur me infrastrukturën që nevojitet për të përmbushur zbatimin e praktikave më të mira mjedisore. Plani nxit një pjesëmarrje më të mirë të gjitha palëve dhe paraqet një këndvështrim strategjik të menaxhimit të mbetjeve, duke e vënë theksin në zgjerimin e zonës së shërbimit, në sasinë në rritje të mbetjeve dhe lehtësirat e nevojshme për menaxhimin e mbetjeve, plani përfshin:

1.1.1 Plani përfshin:

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane për Bashkinë Tropojë përfshin një sërë komponentësh thelbësorë, të cilët së bashku synojnë ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm, efikas dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e mbetjeve. Elementët kryesorë të planit përfshijnë:

1. Analizën e situatës ekzistuese

Vlerësimi i gjendjes aktuale të menaxhimit të mbetjeve në bashki, përfshirë burimet e gjenerimit, infrastrukturën ekzistuese, praktikat e trajtimit dhe problemet kryesore.

2. Vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale

Analiza e kapaciteteve të administratës vendore dhe operatorëve të shërbimit për ofrimin e menaxhimit të mbetjeve.

3. Parashikimet për sasinë dhe përbërjen e mbetjeve

Projeksione për rritjen e mbetjeve në vitet e ardhshme bazuar në tendencat demografike dhe zhvillimet ekonomike.

4. Qëllimet dhe objektivat strategjike

Përcaktimi i qëllimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

5. Masat dhe ndërhyrjet prioritare

Propozimi i masave konkrete për:

- Reduktimin e mbetjeve në burim
- Riciklimin dhe ripërdorimin
- Përmirësimin e grumbullimit dhe transportit
- Trajtimin dhe depozitimin e kontrolluar

6. Edukim dhe ndërgjegjësim i komunitetit

Fushata për informimin dhe përfshirjen e qytetarëve në ndarjen në burim, riciklim dhe mbrojtjen e mjedisit.

7. Aspektet financiare dhe modelet e qëndrueshme të financimit

Vlerësimi i kostove dhe burimeve të financimit për zbatimin e planit, përfshirë mundësinë e partneriteteve publike-private apo fondeve të huaja.

8. Plan i veprimit dhe afatet kohore

Një kalendar konkret me hapa të qartë për zbatimin e masave dhe monitorimin e progresit.

9. Sistemi i monitorimit dhe raportimit

Mekanizma për vlerësimin e zbatimit të planit dhe përmirësimet e nevojshme gjatë rrugës. Plan i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është bërë paraprakishjtë prezantim dhe subjekt i diskutimeve me përfaqësuesit e njësive administrative dhe aprovohet nga Këshilli Bashkiak, dhe nëse do të jetë e nevojshme do të marrë edhe miratimin nga instancat e tjera në nivel qarku.

Në këtë seksion fillimor, argumentohet nevoja për zhvillimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU).

Ky plan paraqitet si një mjet strategjik për të adresuar sfidat dhe për të përmirësuar situatën e menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal. Është e rëndësishme të hartohet ky plan për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të menaxhimit të mbetjeve në një qytet ose njësitë administrative të bashkisë Tropojë.

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane për Bashkinë Tropojë është një dokument kyç për të rregulluar dhe organizuar menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. Ky plan është në përputhje me politikat kombëtare për mbetjet dhe synon të ofrojë udhëzime konkrete për grumbullimin, trajtimin, riciklimin dhe heqjen e mbetjeve në mënyrë efikase dhe të volitshme.

Në këtë kontekst, Plani ka disa qëllime kryesore:
Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM): Kjo do të thotë që plani lokal synon të ndihmojë në realizimin e qëllimeve të politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve.

Zgjidhjet për menaxhimin e mbetjeve: PLMIMNU do të propozojë dhe promovojë opsione për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në mënyrë që të përputhen me standardet kombëtare dhe të jenë efikase.

Instrumentet institucionale dhe rregullatore: Planifikimi do të përfshijë hartimin e strukturës institucionale, organizative dhe rregullore të nevojshme për të menaxhuar mbetjet në nivel lokal dhe për të siguruar përputhshmëri me standardet e përcaktuara. Nevojat financiare dhe investimet: PLMIMNU do të identifikojë nevojat financiare për investime në infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve dhe do të sugjerojë mënyra për të siguruar fondet e nevojshme, duke përfshirë financimin nga qeveria qendrore dhe institucionet ndërkombëtare.

Viti 1994 shënoi momentin kur autoriteteve lokale ju deleguan shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbime të tjera pastrimi, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”. Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisjes vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndyrshuar, ku në nenin 12, pika 2 citohet:

Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji. Hartimi i këtij plani është një detyrim ligjor për bashkitë, siç është specifikuar në Ligjin nr.10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Kjo bën që hartimi i Planit të jetë një hap i rëndësishëm në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Tropojë.

1.2 Hartimi i Planit në Bashkinë Tropojë .

Zbatimi i Planit Lokal në bashkinë Tropojë do të përfshijë të gjithë territorin e kësaj bashkie në kufijtë siç janë përcaktuar në ligjin nr. 115/2014 (31.07.2014). “Për ndarjen territoriale administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Në kuadër të zbatimit të Planit, Bashkia Tropojë do të krijojë një bazë të dhënash për mbetjet (gjenerimi i mbetjeve, përbërja merceologjike e tyre, monitorimi i fraksioneve të ndryshme të mbetjeve)

dhe përditësimi i tij çdo vit, i cili është një prej veprimeve më të rëndësishme për monitorimin e zbatimit të tij, për arsyet e mëposhtme dhe jo vetëm:

Planifikimi për administrimin e mbetjeve - është e pamundur të bësh një planifikim të saktë pa pasur të dhëna të sakta mbi normën e gjenerimit dhe tipologjinë e mbetjeve.

Zhvillimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve - veçanërisht mbledhja e diferencuar e mbetjeve kërkon të identifikohen saktësisht fraksionet në peshë dhe përqindje e mbetjeve në procesin e planifikimit dhe projektimit për ndërtimin e impianteve për trajtimin final të tyre.

Zhvillimi i programeve të parandalimit dhe minimizimit të mbetjeve - identifikimi dhe vlerësimi i fraksioneve të riciklueshme është një hap i rëndësishëm drejt reduktimit dhe parandalimit të mbetjeve.

Fushatat e ndërgjegjësimit për mbetjet - të dhënat e gjeneruara do të jenë shumë të dobishme për aktorë të ndryshëm të cilët duan të piketojnë zona pilot për të aplikuar ndarjen e mbeturinave në burim dhe për të stimuluar riciklimin.

Në përpjekje për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Tropojë, u zhvillua Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU). Ky plan u hartua në kuadër të projektit "Mbështetje Bashkisë Tropojë në drejtorinë e shërbimeve publike".

Plani është një dokument i përgatitur me synimin për të treguar dhe promovuar zgjidhjet teknike efektive për menaxhimin e integruar të mbetjeve, që përfshin mbulimin me këtë shërbim për të gjithë territorin e bashkisë, instalimin e një sistemi grumbullimi të diferencuar si dhe identifikimin e destinacioneve për mbetjet e riciklueshme dhe të pariciklueshme, me qëllim reduktimin e mbetjeve dhe nxitjen e riciklimit në Bashkinë e Tropojë.

Paralelisht me të, dhe me ndërgjegjësimin e qytetarëve për diferencimin e mbetjeve që në burim, Bashkia synon të rrisë cilësinë e shërbimit, për reduktimin e rrezikut në shëndetin e njerëzve e në mjedis dhe qëndrueshmërinë e tij, duke përmirësuar dhe financat, jo vetëm nga tarifat e shërbimit, por edhe nga aktivitetet e tjera menaxhuese.

Plani i jep të gjitha mundësitë Bashkisë Tropojë të zgjerojë territorin e bashkëpunimit për çështje të veçanta të menaxhimit të mbetjeve edhe me bashkitë Tropojë dhe Tropojë, siç janë përpunimi i mbetjeve në landfill, apo për çështje të tjera që lidhen parandalimin e depozitimit të mbetjeve në liqenin e Fierzës nëpërmjet rrjedhave ujore që lidhin të dy vëndet Kosovën dhe Shqipërinë.

2. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETJEVE


2.1 Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve Politikat kombëtare në fushën e menaxhimit të mbetjeve përqendrohen në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve. Këto dokumente vendosin drejtimin dhe objektivat e politikës së Qeverisë së Shqipërisë në këtë fushë për periudhën deri në 2025. Synimi kryesor është minimizimi i ndikimit të mbetjeve në mjedis në nivele kombëtare dhe lokale, si dhe përmirësimi i përdorimit efikas të burimeve në vend.

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve vendos katër shtylla kryesore për zbatimin e politikës dhe strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (PKMM).

Këto shtylla politike janë:

- **Planifikimi:** Zhvillimi i planeve për të përparuar axhendën e strategjisë së mbetjeve në lidhje me zbatimin.
- **Edukimi:** Edukimi i partnerëve dhe bashkëpunëtorëve kryesorë për të përmbushur potencialin e tyre brenda sistemit dhe për të lehtësuar zbatimin e reformave.
- **Mbështetja financiare:** Mbështetja financiare e burimeve njerëzore dhe vetë sistemit në mënyrën e duhur.
- **Kuadri ligjor:** Përafrimi me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit për të siguruar hyrjen e suksesshme në BE në të ardhmen.
- Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

Hierarkia e mbetjeve: Përparësitë në menaxhimin e mbetjeve vendosin "parandalimin dhe ripërdorimin" si alternativa më të preferueshme.



- **Parimi reduktues:** Minimizimi i gjenerimit të mbetjeve për të ruajtur burimet natyrore.
- **Parimi parandalues:** Reduktimi i impaktit të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.
- **Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:** Mbetjet të trajtohen sa më afër vendit të prodhimit për të shmangur eksportin në vende të tjera.
- **Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit:** Parimi “Ndotësi paguan” kërkon që prodhuesit duhet të mbulojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe po punon për të përafruar dhe adoptuar legjislacionin në përputhje me standardet e BE-së. Në vitet e fundit, ka pasur përmirësime të konsiderueshme në fushën e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri për të përmbushur standardet e Bashkimit Evropian.

3. ASPEKTE INSTITUCIONALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Turizimit dhe Mjedisit, Ministria infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi, MTM është institucioni i specializuar dhe përgjegjës kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në

varësi të saj: Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMPU) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Agjensive Rajonale të Mjedisit (ARM).

ISHMPU (në zbatim të Ligjit nr. 10431) është përgjegjës dhe ushtron aktivitetin për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor (ku përfshihen edhe mbetjet) në të gjithë vendin për të gjithë konsumatorët që gjenerojnë mbetje. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore të miratuara dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve (ku përfshihen dhe mbetjet), rregulloret teknike dhe teknologjitë. ISHMPU bashkëpunon me autoritete të tjera në nivel qendror, rajonal dhe lokal (si p.sh. ARM, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ISHSH, IKMT-ja, Policinë Bashkiake etj.) për përmbushjen e detyrave të këtyre të fundit.

Agjensitë Rajonale të Mjedisit (në zbatim të Ligjit nr. 10431) janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal dhe, bashkë me AKM-më si njësi qendrore, përbëjnë rrjetin e agjencive mjedisore. Ato kanë për detyrë: (i) të realizojnë zbatimin e ligjeve mjedisore dhe atyre të manaxhimit të mbetjeve në nivel lokal dhe rajonal; (ii) të bashkëpunojnë me autoritetet lokale në zhvillimin e aksioneve, planeve, projekteve apo fushatave të sensibilizimit në nivel lokal; (iii) kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

MIE dhe më konkretisht Drejtoria e Politikave të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta ka për detyrë formulimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, normave dhe standardeve për shërbimet publike në fushën e mbetjeve urbane apo mbetjeve të tjera. MIE është autoriteti përgjegjës në nivel kombëtar për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve publike në fushën e manaxhimit të mbetjeve, rehabilitimit të fushave të venddepozitimeve, ngritjes së landfill-eve etj. Në zbatim të kuadrit ligjor, ajo duhet të përgatisë rregullore, teknika dhe metoda për të gjitha proceset e manaxhimit të mbetjeve si ndarja dhe grumbullimi i tyre, transporti dhe riciklimi, trajtimi dhe groposja etj. Gjithëqë, MTI është autoriteti kontraktues për koncesionin e aktiviteteve ekonomike nën përgjegjësinë e saj, duke përfshirë fushën e shërbimeve publike ku bën pjesë edhe manaxhimi i mbetjeve.

Këshilli Kombëtar i Territorit, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhojë edhe për landfill-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me MTM dhe në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve harton rregullore për manaxhimin e mbetjeve në nivele

të ndryshme të hierarkisë së manaxhimit të tyre dhe gjithë Tropojëtu harton dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore (miratuar Udhëzimi Nr. 6, dt. 30.11.2007);

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është një autoritet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai bashkëpunon me Inspektoratet Mjedisore dhe në raste të veçanta, edhe me inspektorate të tjera, sikurse edhe me autoritetet lokale për kryerjen e inspektimeve të aktiviteteve që lidhen me mbetjet. Aktiviteti i inspektoratit mbështetet në ligjin 7904 datë 8.3.1995 dhe ka për detyrë të vendosë gjopa për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë. Përgjegjësia e inspektoratit shtrihet edhe në përcaktimin e vendgrumbullimit të mbetjeve.

Spitalet dhe gjithë prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore si dhe për projektimin e skemave të manaxhimit të mbetjeve të tyre, në përputhje me Planet Kombëtare të Manaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Manaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për:

- Mbetjet industriale
- Mbetjet minerale
- Rehabilitimin e vend-depozitimeve në përputhje me specifikat.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për mbetjet bujqësore dhe shtazore.

Ministria e Financës (në bashkëpunim me MM) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për paraqitjen e taksave të ndryshme mjedisore.

Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 bashkitë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia përcakton:

1. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të manaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
2. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për manaxhimin e mbetjeve urbane në

territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;

3. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë manaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret "tip" të miratuara nga MM, MTI dhe MSH;
4. Harton planet e manaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
5. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
6. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

1. Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
2. Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
3. Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e manaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;
4. Të inspektojnë "zotëruesin e mbetjeve" për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
5. Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e manaxhimit të mbetjeve;
6. Të bashkëpunojë me ISHMPU, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal;
7. Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet.

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme.

Policia e bashkiake është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me manaxhimin e mbetjeve

3.3 Informacion përmbledhes mbi legjislacionin

Në tabelën më poshtë është bërë një përmbledhje e kuadrit ligjor Shqiptarë në fushën e Menaxhimit të mbetjeve:

Kuadri Ligjor për Menaxhimin e Mbetjeve	
Ligjet	Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013
	Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme”
	Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
VKM-të	VKM nr. 428, datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane”
	VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
	VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
	VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura "
	VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura"
	VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte "
	VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"

VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve"
VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"
VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
VKM nr.52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit scrap pushojnë së qeni mbetje"
VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit scrap pushojnë së qeni mbetje"
VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"
VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"
VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"
VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"

	VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
	VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"
	VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve"
Udhëzime	Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"

Përmbledhje e kuadrit ligjor

4. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

4.1 Të dhëna gjeografike dhe demografike


Pozita Gjeografike

Bashkia Tropojë është një nga bashkitë më verioro-verilindore të Republikës së Shqipërisë dhe bën pjesë në përbërje të qarkut Kukësit . Ajo shtrihet në një territor me sipërfaqe prej **rreth 1,043 km²**, duke u renditur ndër bashkitë më të mëdha të vendit për nga hapësira territoriale. Pozita e saj kufitare i jep një rëndësi të veçantë strategjike, si në aspektin e bashkëpunimit ndërkufitar, ashtu edhe për zhvillimin ekonomik, turizmin dhe ruajtjen e burimeve natyrore.

Bashkia kufizohet:

- në veri me Republikën e Malit të Zi
- në lindje me Republikën e Kosovës
- në jug me Bashkinë Has
- në perëndim me Bashkinë Malësi e Madhe (qarku Shkodër).

Qendra e bashkisë është qyteti i **Bajram Currit**, i cili ndodhet në një pozicion gjeografik të favorshëm në luginën e lumit Valbonë, i rrethuar nga male të larta dhe me akses të drejtpërdrejtë në rrugë rajonale dhe kombëtare. Bashkia përfshin disa njësi administrative si: **Tropojë, Margegaj, Bujan, Bytyç, Fierzë, Lekbibaj dhe Llugaj.**



Relievi i Tropojës është kryesisht malor dhe alpin, me lartësi që variojnë nga 190 metra në zonat e ultësirës, deri në 2,694 metra në **Majën e Jezercës**, që është maja e dytë më e lartë në territorin e Shqipërisë. Kjo morfologji unike natyrore përfshin luginat e thella, masivet e dendura pyjore, formacione shkëmbore dhe peizazhe të rralla alpine që ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, bujqësisë malore dhe ruajtjen e biodiversitetit.

Bashkia Tropojë përshkohet nga lumenj me rëndësi si **Valbona** dhe **Gashi**, të cilët jo vetëm që përfaqësojnë pasuri ujore të rëndësishme, por gjithashtu janë pjesë e zonave të mbrojtura kombëtare dhe ndërkombëtare. Zona përfshihet në mënyrë të konsiderueshme në **Parkun Kombëtar të Luginës së Valbonës** dhe **Rezervatin e Rrethinës së Gashit**, që është shpallur pjesë e **Trashëgimisë Botërore Natyrore të UNESCO-s** si pyll i virgjër alpin.

Kjo pozitë gjeografike e bën Bashkinë Tropojë një zonë me potencial të lartë zhvillimi në fushat e turizmit natyror, prodhimit bujqësor ekologjik, ruajtjes së biodiversitetit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Njëkohësisht, sfidat që burojnë nga terreni i thyer, infrastruktura rrugore e kufizuar dhe largësia nga qendrat urbane të mëdha, kërkojnë një planifikim të kujdesshëm dhe të integruar në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.

Bashkia Tropojë, megjithëse një nga zonat më të pasura natyrore në Shqipëri përsa i përket biodiversitetit, ujërave të pastra, peizazheve alpine dhe resurseve pyjore, përballët me një sërë sfidash dhe problematikash mjedisore që lidhen kryesisht me zhvillimin e pakontrolluar, mungesën e investimeve në infrastrukturë mjedisore, presionin njerëzor mbi ekosistemet dhe mungesën e ndërgjegjësimit publik. Këto probleme ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mjedisit dhe në mundësinë për zhvillim të qëndrueshëm të zonës.

1. Mbetjet urbane dhe rurale

- Mungesa e sistemit të integruar për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë, veçanërisht në fshatra dhe zona të thella.
- Hedhja e mbetjeve në natyrë, buzë lumenjve, në pyje dhe në rrugët rurale.
- Mungesa e vendgrumbullimeve të certifikuara dhe të menaxhuara sipas standardeve mjedisore.

2. Ndotja e ujërave

- Derdhja e ujërave të zeza pa trajtim në lumenj dhe përrrenj, përfshirë Valbonën dhe Gashin.
- Rrezikim i burimeve të ujit të pijshëm për shkak të ndotjes nga mbetjet dhe mungesa e rrjeteve të kanalizimeve në zonat rurale.

3. Dëmtimi i pyjeve

- Dëmtimet nga zjarret.
- Erozioni i tokës si rezultat i mungesës së rigjenerimit pyjor.

4. Zhvillimi turistik pa kontroll mjedisor

- Ndërtimet e pakontrolluara në zonat e mbrojtura, që çënojnë habitatet natyrore dhe peizazhin.
- Rritja e presionit turistik në muajt e verës, duke tejkaluar kapacitetet mjedisore të zonës.
- Mungesa e menaxhimit të mbetjeve dhe kanalizimeve në struktura turistike në fshatra.

5. Rreziqet nga ndryshimet klimatike

- Shkurtimi i stinës së borës dhe rritja e temperaturave ndikon në zhvendosjen e habitateve të florës dhe faunës alpine.
- Rritje e frekuencës së zjarreve në pyje gjatë verës për shkak të thatësisë dhe mungesës së monitorimit.

6. Degradimi i tokës bujqësore

- Përdorimi i pakontrolluar i kimikateve në disa zona, sidomos në luginat bujqësore.
- Braktisja e tokave dhe mungesa e sistemit të vaditjes krijojnë probleme në ruajtjen e cilësisë së tokës.

7. Mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor

- Nivel i ulët informimi i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- Mungesë e përfshirjes së shkollave dhe organizatave lokale në aktivitete për mjedisin.

Përfundim

Për të adresuar këto problematika, Bashkia Tropojë ka nevojë për:

- investime në infrastrukturë mjedisore (landfille, kanalizime, impiante të trajtimit),
- përforcim të strukturave inspektuese dhe zbatimit të ligjit,
- fushata të edukimit dhe ndërgjegjësimit,
- menaxhim të integruar të turizmit dhe zonave të mbrojtura.
- Përmirësimi i sistemit vaditës .

4.2 Të Dhëna Demografike – Bashkia Tropojë

1. Popullsia sipas Njësive Administrative

Bashkia përbëhet nga 8 njësitë administrative, me një total prej **28 224 banorësh** të regjistruar sipas zyrës së gjendjes civile bashkia Tropojë.

Njësia Administrative	Popullsia 2023	Meshkuj	Femra
Bajram Curri	8037	4122	3915
Tropojë (fshati)	5758	3009	2749
Margegaj	3254	1681	1573
Bujan	2869	1460	1409
Fierzë	2372	1216	1156
Llugaj	2250	1091	1159
Bytyç	2149	1101	1048
Lekbibaj	1535	807	728
Totali	28 224	14 487	13 737

2. Struktura Gjeneruese dhe Grupmosha për Njësitë Administrative

Nga të dhënat e Censurit 2023 (më të detajuara sipas njësive administrative)

Njësia Administrative	Gjithsej	Meshkuj	(0–14/15–64/65+)	Femra	(0–14/15–64/65+)
Bajram Curri	4,113	2,026	352 / 1347 / 327	2,087	319 / 1,444 / 324
Tropojë (fshati)	2,560	1,286	217 / 897 / 202	1,274	220 / 818 / 236
Margegaj	1,907	941	180 / 601 / 160	966	168 / 617 / 181
Bujan	1,738	864	162 / 529 / 173	874	245 / 534 / 195

Njësia Administrative	Gjithsej	Meshkuj	(0–14/15–64/65+)	Femra	(0–14/15–64/65+)
Fierzë	1,149	589	100 / 381 / 108	560	92 / 352 / 116
Llugaj	1,190	573	128 / 362 / 83	617	106 / 394 / 117
Bytyç	888	445	80 / 293 / 72	443	65 / 304 / 74
Lekbibaj	644	349	52 / 236 / 61	295	55 / 182 / 58
Totali Bashkia	14,189	7073	1244/4646/1186	7,116	1270/4645/1301

Këto të dhëna japin një bazë për analizë demografike në planin përkatës, dhe mund të përdoren si afat-referencë për ndryshimet ndër vite.

Treguesit e sygjjeruar gjinorë dhe socialë për Planin vendor të Menaxhimit të Mbetjeve

Fusha	Treguesi	Njësia Matëse	Vlera për Tropojën	Shënime / Burimi
Akses dhe përfshirje	Përqindja e njësive administrative që ofrojnë shërbim për komunitetet rome dhe egjiptiane	%	100%	Në Tropojë ka komunitete rome/egjiptiane të identifikuar
Akses dhe përfshirje	Përqindja e familjeve në ndihmë ekonomike që mbulohen me të rregullt shërbim pastrimi	%	80%	Bazuar në mbulimin territorial të shërbimit të pastrimit nga ndërmarrja lokale
Akses dhe përfshirje	Përqindja e familjeve në nevojë që përfitojnë lehtësi fiskale për tarifat e shërbimeve publike (Tarifa e pastrimit)	%	100%	Bazuar në paketën fiskale të miratuar në KB për vitin 2025
Pjesëmarrje dhe vendimmarrje	Përqindja e grave dhe grupeve vulnerabël të përfshira në konsultimet publike për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve	%	15%	Në takimet e zhvilluara, përfaqësimi i grave ka qenë i ulët
Punësim dhe ekonomi qarkulluese	Përqindja e grave dhe personave vulnerabël të punësuar në sektorin e mbetjeve dhe të riciklimit	%	20%	Nga 31 punonjës në Sektorin e Pastrimit janë të punësuar 10 punonjëse femra
Cilësia e shërbimit	Përqindja e ankesave për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve të adresuara në zonat me komunitet vulnerabël	%	TBD	Të dhënat nuk janë të disagreguara sipas komuniteteve
Ndërgjegjësim dhe edukim	Numri i fushatave për ndarjen në burim të mbetjeve që targetojnë gra, fëmijë dhe komunitete në nevojë	Numër	1	Një fushatë e zhvilluar me komunitetin në 2024-2025

Transparencë dhe llogaridhënie	Përqindja e informacionit të publikuar mbi kontratat dhe tarifat e mbetjeve në mënyrë të kuptueshme për publikun	%	70%	Të dhënat bazë mbi tarifat janë publike, jo plotësisht të kuptueshme
--------------------------------	--	---	-----	--

3. Migrimi i Brendshëm dhe Mosha Mesatare

- Sipas raportit të vitit 2023, Bashkia Tropojë përjeton një **neto-migrim të brendshëm** me humbje prej rreth **–168 banorë në vit**.
- Popullsia në rënie reflekton reduktim në grupmoshat e reja dhe ndikim të emigracionit drejt qyteteve të mëdha dhe jashtë vendit.
- Mosha mesatare nuk është publikuar në nivel bashkie, por tendencat e ndryshme demografike dhe migracioni i të rinjve sugjerojnë se mosha mesatare është e lartë dhe rritet (për shkak të largimit të të rinjve dhe lindshmerise në rënie).

Impakt në Planin e Menaxhimit të Mbetjeve

- **Tkurrja qendrore e popullsisë** në njësi të caktuara (si Bajram Curri me densitet më të lartë) kërkon mbështetje më intensive për ofrimin e shërbimit të pastrimit.
- **Migracioni i brendshëm negativ** sugjeron fokus në optimizim të shërbimit në njësitë me popullsi në rënie dhe konsolidim në ato me mbetje operative.
- Strategjitë edukimi dhe sensibilizimi duhet të përshtaten me përbërjen gjinore dhe moshore të çdo njësie.

4.3 Struktura Ekonomike

Bashkia Tropojë ka një ekonomi kryesisht **bujqësore dhe pyjore**, me potencial të konsiderueshëm në sektorin e turizmit natyror dhe zhvillimin rural. Struktura ekonomike është e karakterizuar nga:

4.3.1.1 1.Bujqësia dhe Blegtoria

- **Bujqësia malore:** Kultivimi i produkteve bujqësore si misri, gruri, perimet dhe veçanërisht gështenja, e cila është një produkt tradicional i zonës. Bujqësia është kryesisht në nivel familjar dhe me teknologji tradicionale.
- **Blegtoralia:** Shumë familje merren me blegtorinë e vogël dhe të mesme, duke ofruar produkte të freskëta si qumësht, djathë dhe mish.
- **Pyjet dhe industria e drurit:** Tropoja ka sipërfaqe të mëdha pyjore, që janë burim i drurit të zjarrit dhe drurit industrial, por ky sektor përballlet me sfida lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

2. Burimet e të Ardhurave

- Shumica e të ardhurave të familjeve vijnë nga bujqësia, blegtoria dhe aktivitetet rurale.

- Migrimi i madh ka sjellë edhe remitancat nga diaspora, që janë një burim i rëndësishëm financiar për familjet lokale.
- Pjesa e sektorit formal është e kufizuar dhe shumë pak industrializim apo shërbime zhvillohen në mënyrë të organizuar.

3. Infrastrukturë Ekonomike

- Infrastruktura rrugore është e kufizuar, veçanërisht në zonat rurale dhe malore, duke vështirësuar qarkullimin e produkteve dhe aksesin në tregje.
- Mungojnë investimet në impiante për përpunimin e produkteve bujqësore dhe të drurit.
- Ka mungesë të infrastrukturës bazë për riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve industriale dhe urbane.

4. Sfida Ekonomike

- Niveli i lartë i varfërisë dhe papunësisë, veçanërisht në zonat rurale.
- Emigracioni i të rinjve drejt qyteteve të mëdha apo jashtë vendit, duke çuar në plakjen e popullsisë dhe zvogëlim të fuqisë punëtore.
- Mungesa e investimeve në teknologji bujqësore moderne dhe shërbime mbështetëse.
- Mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin, e cila ndikon negativisht në mjedis dhe ekonominë lokale.

5. Potenciale Zhvillimi

- **Turizmi ekologjik dhe malor**, duke përfutur nga peizazhet e bukura natyrore, parkun kombëtar dhe trashëgimia kulturore.
- **Agrikultura organike dhe produkte tradicionale**, duke promovuar produktet tipike si gështenja, mjaltë, dhe produkte të bulmetit.
- **Investime në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve** dhe zhvillimin e industrisë së drurit me qëndrueshmëri.
- **Zhvillimi i shërbimeve të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve**, që mund të krijojë vende pune dhe të përmirësojë kushtet mjedisore.

4.3.1.2 2.Turizmi

Bashkia Tropojë është një nga destinacionet më të rëndësishme natyrore në Shqipëri, e njohur për bukuritë e saj malore, lumenjtë e kristaltë, parkun kombëtar të Valbonës dhe trashëgiminë kulturore. Turizmi në këtë zonë ka potencial të madh për zhvillim, duke ofruar ekoturizëm, turizëm malor dhe kulturor.

2. Llojet e Turizmit

- **Turizmi malor dhe natyror:** Ekskursionë në Parkun Kombëtar të Valbonës, hiking, sporte dimërore dhe eksplorime të faunës dhe florës.

- **Turizmi rural:** Vizita në fshatra të traditës me arkitekturë karakteristike dhe gatime tradicionale.
- **Turizmi kulturor:** Festat dhe ngjarjet lokale, muzetë dhe trashëgimia historike.
- **Turizmi aventurë:** Rafting në lumenj, ngjitje në male, dhe sporte të tjera ekstreme.

3. Infrastrukturat dhe Shërbimet

- Ndërtesat dhe akomodimi janë në zhvillim, me një numër të rritur strukturash mikpritëse si hotele të vogla, shtëpi pritëse dhe kampingje.
- Rrjetet rrugore kanë përmirësuar aksesin, por ka ende sfida në zona malore të vështira për t'u arritur.
- Shërbimet turistike përfshijnë guida lokale, restorante me produkte autentike dhe aktivitete të organizuara.

4. Sfida në Zhvillimin e Turizmit

- Mungesa e planifikimit të qëndrueshëm turistik dhe infrastrukturës së mbetjeve, që rrezikon ndotjen e zonave natyrore.
- Presioni mbi burimet natyrore gjatë sezonit të lartë turistik, që mund të çojë në degradim mjedisor.
- Mungesa e ndërgjegjësimit për ruajtjen e mjedisit dhe praktikat e qëndrueshme të turizmit nga operatorët lokalë.
- Investime të pamjaftueshme në marketing dhe promovim ndërkombëtar.

5. Mundësi dhe Potenciale

- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm duke integruar menaxhimin e mbetjeve dhe edukimin mjedisor.
- Bashkëpunimi me komunitetin lokal për zhvillimin e aktiviteteve turistike që ruajnë traditat dhe natyrën.
- Krijimi i rrjetit të ecjeve dhe pikave turistike të mirëorganizuar dhe të mirëmbajtura.
- Përdorimi i burimeve natyrore dhe kulturore për promovim dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

4.3.1.3 3. Industria e Vogël dhe Punësimi

Bashkia Tropojë karakterizohet kryesisht nga një ekonomi rurale dhe bujqësore, ku industria e vogël ka një rol të kufizuar. Sektori i industrisë së vogël përbëhet kryesisht nga:

- **Prodhimi tradicional bujqësor dhe ushqimor**, si përpunimi i produkteve të bulmetit, mjalit, gështenjës dhe produkteve të tjera lokale.
- **Punët artizanale dhe dorezisë**, që lidhen me traditat kulturore dhe produktet turistike.
- **Ndërtimi dhe shërbimet lokale**, me ndërmarrje të vogla që ofrojnë punë në ndërtim dhe mirëmbajtje.

2. Niveli i Punesimit

- Puna në Bashkinë Tropojë mbetet kryesisht në sektorin informal dhe bujqësor, me një përqindje të vogël të punësimit në sektorin formal industrial dhe shërbime.
- Shkalla e papunësisë është relativisht e lartë, veçanërisht tek të rinjtë dhe në zonat rurale.
- Shumë të rinj migrojnë drejt qyteteve të mëdha ose jashtë vendit për kërkim pune, duke ulur fuqinë punëtore në zonë.

3. Sfida në Zhvillimin e Industrisë së Vogël dhe Punesimit

- Mungesa e kapitalit dhe infrastrukturës moderne për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla.
- Kufizimet në aksesin në tregje të gjera dhe mungesa e mbështetjes për inovacion dhe teknologji.
- Papunësia strukturore dhe largimi i forcës punëtore të kualifikuar.
- Mungesa e programeve të trajnimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale në nivel lokal.

4. Mundësi për Zhvillim

- Promovimi i produkteve tradicionale dhe zhvillimi i markave lokale që mund të hyjnë në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Ngritja e inkubatorëve të biznesit dhe programeve të mbështetjes për ndërmarrjet e vogla.
- Investime në trajnimin profesional dhe përgatitjen e fuqisë punëtore për kërkesat e tregut.
- Zhvillimi i shërbimeve dhe industrisë së lehtë, duke përfshirë riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve si një sektor potencial pune.

4.3.1.4 4. Shërbimet dhe Infrastrukturë

- Bashkia Tropojë ka një rrjet rrugor që lidh kryesisht qendrën urbane Bajram Currin me fshatrat dhe zonat malore.
- Rrugët kryesore janë të asfaltuara, por shumë rrugë rurale janë të pakalueshme gjatë dimrit ose në kohë me reshje të mëdha.
- Mungesa e transportit publik në disa zona e vështirëson lëvizjen e banorëve dhe qarkullimin e produkteve bujqësore.

2. Shërbimet Publike

- Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimeve janë të pranishme kryesisht në qendrën e bashkisë dhe disa fshatra më të mëdha.
- Në zonat rurale shpesh mungon infrastruktura e kanalizimit, duke shkaktuar ndotje të tokës dhe ujërave sipërfaqësore.
- Bashkia po punon për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe zgjerimin e rrjetit në zonat më të largëta.

3. Energjia Elektrike

- Furnizimi me energji elektrike mbulon shumicën e territorit, megjithëse në zonat malore ka ndërprerje të shpeshta, sidomos gjatë dimrit.
- Ka nevojë për investime në modernizimin e rrjetit dhe burimeve të energjisë së ripërtëritshme.

4. Infrastrukturë Shëndetësore dhe Arsimore

- Në Bajram Curri dhe njësitë kryesore ka qendra shëndetësore dhe shkolla, por në fshatra të largëta mungesa e shërbimeve është e dukshme.
- Infrastrukturat shëndetësore janë të kufizuara dhe me mungesë personeli, që ndikon në aksesin e banorëve ndaj kujdesit mjekësor.

5. Infrastrukturë për Menaxhimin e Mbetjeve

- Bashkia disponon shërbime bazë të pastrimit dhe mbledhjes së mbetjeve në qytet dhe disa fshatra.
- Nuk ka ende një sistem të zhvilluar për ndarjen në burim, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve industriale dhe organike.

6. Teknologji dhe Komunikacion

- Rrjeti i telekomunikacionit dhe internetit është në përmirësim, por në zonat malore dhe rurale mbetet i kufizuar.
- Modernizimi i komunikimit është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe shërbimeve publike.

4.3.1.5 5.Tregjet dhe Eksporti

1. Tregjet Lokale dhe Rajonale

- **Tregjet kryesore të Bashkisë Tropojë** janë në qytetin Bajram Curri, ku zhvillohen tregje të përditshme me produkte bujqësore, ushqimore, dhe mallra të ndryshme.
- Fshatrat dhe njësitë administrative kanë tregje më të vogla lokale, ku kryesisht shiten produktet e zonës për banorët lokalë.
- Mungesa e rrjeteve të mëdha tregtare dhe infrastrukturës kufizon zhvillimin e tregtisë së organizuar në zonë.

2. Eksporti i Produkteve

- Eksporti nga Tropoja fokusohet kryesisht në **produkte bujqësore dhe pyjore**, si Boronice, gështenja, druri, mjaltë dhe produkte të bulmetit.

- Boronica dhe Gështenja janë dy nga produktet kryesore me potencial eksporti në tregjet rajonale dhe europiane.
- Industria e përpunimit dhe paketimit të produkteve eksportuese është në zhvillim e sipër, por kërkon investime dhe modernizim.

3. Sfidat në Tregtim dhe Eksport

- Mungesa e certifikimeve të produkteve organike dhe standardeve ndërkombëtare pengon hyrjen në tregje të mëdha.
- Logjistika dhe infrastruktura e transportit janë të kufizuara, duke rritur kostot e eksportit dhe vonesat.
- Nuk ka rrjete të forta bashkëpunimi midis prodhuesve dhe ndërmarrjeve për të rritur kapacitetet e eksportit.

4. Mundësi për Zhvillim

- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit dhe magazinimit për të lehtësuar qarkullimin e mallrave.
- Mbështetja për certifikime të produkteve dhe standardizim për tregjet ndërkombëtare.
- Zhvillimi i bashkëpunimeve midis fermerëve, ndërmarrjeve të vogla dhe institucioneve për përmirësimin e zinxhirit të vlerës.
- Promovimi i markës “Tropojë” për produkte tradicionale dhe organike si një vlerë e shtuar për eksport.

4.3.1.6 Mbështetje Nga Fondet Kombëtare dhe Ndërkombëtare

- **Programet e Qeverisë Shqiptare:** Bashkia përfiton fonde nga programet kombëtare për zhvillim rural, bujqësi, menaxhim mjedisor dhe infrastrukturë.
- **Fondi i Zhvillimit Rajonal:** Investime për përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve dhe zhvillimit ekonomik në zonat rurale si Tropoja.
- **Programi Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve:** Financime për krijimin e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe riciklimit në nivel vendor.
- **MBPP (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural):** Projekte për mbështetje të fermerëve dhe zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë.

Fondet Ndërkombëtare

- **Bashkimi Evropian (BE):** Programi IPA dhe Horizon Europe mbështetin projekte për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhim mjedisor, energji të ripërtëritshme dhe zhvillim rural.
- **Bankat Ndërkombëtare (Banka Botërore, BERZH):** Financime dhe asistencë teknike për projekte infrastrukturore dhe zhvillimore në zonat malore dhe rurale.

- **Organizata Ndërkombëtare dhe Fondacione:** UNDP, GIZ, FAO dhe të tjera ofrojnë fonde dhe ndihmë teknike për projekte të menaxhimit të pyjeve, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit rural.
- **Fondet e IPA për Shqipërinë:** Fondet për bashkëpunim rajonal, zhvillim ekonomik dhe menaxhim mjedisor me fokus në zonat me potencial turistik dhe pyjor.

4.4 Analiza e gjendjes për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2021-2025

Shërbimi i pastrimit dhe mbetjeve kryhet nga drejtoria e Shërbimeve Komunitare, nën Sektorin e Pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Tropojë. Bashkia ofron shërbimin e pastrimit në 70% të zones urbane dhe semiurban ku përfshihen 8 njësi administrative Njesia Qendër (Bajram Curri) , (NJA Tropojë, NJA Llugj, NJA Bujan, NJA Lekbibaj, NJA Fierzë, NJA Berishë-Bytyç, NJA Mrgegaj). Shërbimi ofrohet çdo ditë të javës sipas zonave të përcaktuara nga ndarja e lagjeve të qytetit. Drejtoria e Shërbimeve ka në dispozicion 3 mjete teknologjike sipas skemës 1+2 (1 shofer dhe 2 punëtorë). E njëjta skemë aplikohet dhe në Njësit e përmendura me sipër të cilave ju vjen në ndihmë kamioncina me skemën 1+ 2 (1 shofer dhe 2 punëtorë), për pastrim në zona ku makina teknologjike për arsye të distancës dhe infrastrukturës nuk ka qene e mundur të shkojë është kryer në këtë mënyrë.

Aktualisht, në bashkinë Tropojë funksionojnë një vend-depozitim për mbetjet urbane, në Koj i cili është funksional.




Figura 2- Pika e depozitimit të mbetjeve.

Ka një kapacitet të personelit prej 55 personash. Inventari i makinerive në funksion të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe inerte është 3 (mjete) për vitin 2026 janë parashikuar shtimin e makinerive. Numri i kontinierëve është 500 copë në gjendje të mirë funksionale.



Figura 3 - Mjet i transportit të mbetjeve.

Ndërkohë në Bashkinë Tropojë ka edhe disa zona , të cilat bashkia i konsideron si qendra të mëdha të gjenerimit të mbetjeve:

1. Qyteti Bajram Curri

- Është **qendra administrative** e Bashkisë Tropojë dhe zona me popullsinë më të madhe.
- Ka tregje, institucione publike, shkolla, spitale, biznese dhe restorante.
- Gjeneron **mbetje të përditshme komunale** me volum të lartë.

2. Zona e bllokut të pallateve në lagjet e qytetit

- Përfshin lagjet: **Partizani, Valbona, Dardania, Katund i Vjetër** etj.
- Ka ndërtim të dendur dhe mungesë të menaxhimit selektiv të mbetjeve.
- Shfaq probleme me grumbullimin dhe depozitiminformal.

3. Tregjet dhe zonat tregtare

- P.sh., **tregu i qytetit Bajram Curri** dhe tregjet periodike në njësitë administrative.
- Gjenerojnë mbetje organike, plastike, kartoni, tekstili dhe mbetje nga produktet bujqësore.

4. Njësitë Administrative me aktivitet ekonomik e turistik

- **Valbonë – Margegaj**: Zonë turistike me fluks të lartë gjatë sezonit.
- **Dragobia dhe Rrogami**: Ndikohen nga turizmi dhe kanë struktura akomoduese.
- Mbetjet në këto zona janë kryesisht të **natyrës urbane dhe të shërbimeve** (plastikë, ushqim, pije, paketim etj).

5. Objekte institucionale dhe shkollore

- Spitali, shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, bashkia, komisariati, gjykata.
- Gjenerojnë mbetje të rregullta urbane dhe letër, plastikë, mbetje të printerëve etj.

6. Zonat me aktivitete ndërtimi

- Kryesisht në qytet dhe zonat në zhvillim rreth tij.
- Gjenerojnë **mbetje inerte** (gurë, zhavorr, beton, tulla, mbetje druri etj), që shpesh depozitohen pa leje.

4.5 Burimet njerëzore

Shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve ofrohet nga vetë bashkia. Përgjegjësi i sektorit të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve është Përgjegjësi i Sektorit të Pastrimit dhe Mbetjeve. Detyrat e tij konsistojnë në drejtimin dhe organizimin e punës me brigadierin e grupit të pastrimit, duke mbajtur nën monitorim të vazhdueshëm grupet e punës dhe realizimin e detyrave nga ana e punonjësve. Ai raporton, në mënyrë periodike për gjendjen e sektorit, tek Drejtori i Shërbimeve Komunitare. Përgjegjësi i sektorit të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve përgatit planet mujore e vjetore për sektorin dhe i paraqet për miratim në institucion.

Për menaxhimin e mbetjeve janë në dispozicion 3 shoferë, 5 punëtorë për pastrimin e kontenierëve, të ndarë në tre grupe pune dhe 12 punëtor për pastrime të tjera.

Nr.	Njësia Administrative (NJA)	Nr.Banorëve sipas Censurit 2023	Nr. Banorëve sipas G.J.C	Ofrohet pastrim
1	Bajram Curri (qytet)	4,113	8,037	po/plotësisht
2	Bujan	1,738	2,869	po/pjesërisht
3	Margegaj	1,907	3,254	po/pjesërisht
4	Tropojë	2,560	5,758	po/80%
5	Lekbibaj	644	1,535	po/pjesërisht
6	Bytyç	888	2,149	po/pjesërisht
7	Fierze	1,149	2,372	po/plotësisht
8	Llugaj	1,190	2,250	po/plotësisht

Tabela 2- Situata e ofrimit të shërbimit në bashkinë Tropojë

4.6 Mjetet


4.6.1 Kontenierë

Bashkia, në total, ka në dispozicion një numër të caktuar konetierësh, të cilët janë shpërndarë në qytet dhe në njësitë e saj administrative. Në varësi të kapacitetit të tyre më poshtë përcaktohet edhe numri i tyre:

- 150 kontenier plastik Donacion i Ambasadës Japoneze të ardhur në viti 2022 1.1 m³
- 320 kontenier metalik në gjendje 1.1m³
- 30 kontenier metalik të rinjë 1.1m³ të ardhur në dhjetor 2024 për shpërndarje në tre muajorin e parë të vitit 2025 në njësi administrative.



Shpërndarja e koshave ardhur nga Ambasada Japoneze



Kosha të vendosur në terren rural dhe urban.

4.6.2 Kamionë

Bashkia Tropojë zotëron 3 mjete teknologjike për të kryer largimin e mbetjeve, si më poshtë:

- 1 kamion me kapacitet mbajtës 9 ton.
- 1 kamion me kapacitet mbajtës 8.5 ton.
- 1 kamion me kapacitet mbajtës 8 ton
- 1 kamionçinë në gjendje pune kryen pastrime të mbetjeve inerte dhe voluminoze të ndryshme.



4.7 Mbledhja dhe transporti i mbetjeve

Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Tropojë mbulohet nga strukturat publike të bashkisë dhe ofrohet në qytetin e Bajram Currit dhe në 7 njësi administrative përreth.

- Në qytetin e **Bajram Currit**, pastrimi kryhet çdo ditë të javës, pra 7 herë në javë, për shkak të dendësisë së popullsisë dhe fluksit të lartë të mbetjeve.
- Në **njësinë administrative Llugaj**, pastrimi kryhet 2 herë në javë, duke siguruar një ritëm të rregullt për mbledhjen e mbetjeve në zonat e banuara.
- Në **njësinë administrative Bujan**, shërbimi ofrohet 2 herë në javë, duke mbuluar qendrat e banuara dhe segmentet kryesore rrugore.
- Në **njësinë administrative Tropojë**, grumbullimi i mbetjeve realizohet 3 herë në javë, me një shtrirje më të gjerë për shkak të përqendrimit të disa fshatrave me densitet më të lartë.
- Në **njësinë administrative Margegaj**, shërbimi kryhet 3 herë në javë, përfshirë zonat turistike dhe rurale me prani më të madhe sezonale.
- Në **njësinë administrative Bytyç**, shërbimi i pastrimit realizohet 1 herë në javë, duke marrë parasysh karakterin rural dhe përhapjen e fshatrave.
- Në **njësinë administrative Lekbibaj**, grumbullimi kryhet 1 herë në javë, për zonat me popullsi më të ulët dhe vështirësi infrastrukturore.

Ky organizim synon të përmirësohet më tej në kuadër të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve 2025–2030, me fokus në shtimin e frekuencës, përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për menaxhimin e mbetjeve.




Figura 4- Foto gjatë pastrimit të mbetjeve.

Bashkia Tropojë aktualisht përdor një venddepozitim për mbetjet urbane që ndodhet në zonën e **Kojit**, në një territor të hapur dhe periferik, larg zonave të banuara. Ky venddepozitim shërben si pika kryesore e depozitimit të mbetjeve të mbledhura nga qyteti i **Bajram Currit** dhe nga një pjesë e njësive administrative përreth, si Tropojë, Margegaj, Bujan, Bytyc, Lekbibaj dhe Llugaj.

Vendndodhja e tij është përzgjedhur për shkak të pozicionit të izoluar dhe aksesit të mundshëm për mjetet e transportit të mbetjeve. Megjithatë, venddepozitimi në Koj **nuk përmbush standardet teknike dhe mjedisore të një landfilli të kontrolluar**, dhe funksionon aktualisht si një **vendgrumbullim i hapur**.

Problematikat kryesore të venddepozitimit në Koj përfshijnë:

- Mungesë e izolimit teknik të bazamentit (liner sintetik);
- Mungesë e sistemit për mbledhjen dhe menaxhimin e biogazit dhe ujërave të ndotura;
- Hedhje e pakontrolluar e mbetjeve të përziera, pa selektim apo ndarje në burim;
- Rrezik për ndotjen e tokës, ujërave dhe përhapjen e mbetjeve nga faktorë natyrorë ose kafshë të lira;
- Mungesë e rrethimit, mbulimit periodik dhe kontrollit të aksesit.

Ky vendgrumbullim konsiderohet një zgjidhje e përkohshme dhe përfaqëson një sfidë për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në Bashkinë Tropojë.

Në kuadër të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për periudhën 2025–2030, Bashkia Tropojë parashikon:

- Përmirësimin afatshkurtër të kushteve teknike të vendgrumbullimit në Koj (rrethim, sinjalistikë, mbulim i pjesshëm);
- Hartimin e një studimi për **zhvendosjen ose transformimin e këtij venddepozitimi** në një strukturë më të kontrolluar;
- Krijimin e një **stacioni të përkohshëm transferimi** ose të një zone për përpunimin dhe ndarjen e mbetjeve të riciklueshme;
- Bashkëpunimin me bashki të tjera për përfshirjen në një **sistem rajonal** të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Ky venddepozitim është aktualisht funksional, por kërkon ndërhyrje emergjente për të parandaluar ndikimet mjedisore dhe për të siguruar një trajtim më të sigurt dhe efikas të mbetjeve urbane në territorin e Tropojës.

4.8 Llojet e mbetjeve që identifikohen në Bashkinë Tropojë

Në territorin e Bashkisë Tropojë identifikohen disa kategori kryesore të mbetjeve, që burojnë nga aktivitetet e ndryshme urbane, rurale, ekonomike dhe turistike. Më të zakonshmet janë:

1. Mbetje urbane të përziera (komunale)

Janë mbetjet që prodhohen nga familjet, institucionet dhe bizneset urbane. Përfshijnë:

- Mbetje organike (mbetje ushqimore, lëvore frutash, perimesh, gjethe etj.);
- Letër dhe karton;
- Plastikë e përzier (shishe, ambalazhe);
- Qelq dhe metale të lehta;
- Rroba të vjetra dhe tekstile;
- Mbetje të tjera të zakonshme shtëpiake.

2. Mbetje inerte (ndërtimi dhe prishje)

Prodhohen nga punimet ndërtimore, riparime dhe prishje ndërtesash. Janë mbetje me volum të madh dhe përfshijnë:

- Gurë, zhavorr, tulla, beton;
- Materiale izolimi;
- Dru ndërtimi dhe dritare të vjetra;
- Tokë e tepërt nga gërmimet.

3. Mbetje bujqësore dhe blegtorale

Të pranishme kryesisht në zonat rurale. Përfshijnë:

- Mbetje bimore nga fushat dhe kopshtet;
- Pleh organik dhe mbetje kafshësh;
- Qese plastike dhe ambalazhe pesticidesh;
- Rrjeta, tubacione dhe mjete të përdorura bujqësore.

4. Mbetje të riciklueshme

Këto gjenden në përbërje të mbetjeve të përziera, por mund të ndahen dhe të trajtohen veçmas:

- Plastikë (PET, PVC);
- Letër dhe karton i pastër;
- Kanaçe alumini dhe qelq;
- Pajisje elektrike dhe elektronike (në raste të veçanta).

5. Mbetje të rrezikshme në sasi të vogla

Nuk janë shumë të përhapura, por ndodhin në sasi të kufizuara. Përfshijnë:

- Bateritë dhe akumulatorët;
- Vajra të përdorur (nga automjetet ose punishte);
- Spërkatës pesticidesh dhe produkte kimike të skaduara;
- Ampula mjekësore dhe mbetje të vogla farmaceutike.

6. Mbetje turistike dhe sezonaliteti

Në zonat me frekuentim të lartë turistik (Valbonë, Dragobi, Rragam, Curraj i Epërm etj.), gjatë sezonit veror ka një rritje të ndjeshme të mbetjeve si:

- Ambalazhe plastike dhe kanaçe;
- Mbetje nga piknikët dhe kampingjet;
- Mbetje organike nga aktivitetet shërbyese (bar, restorante, bujtina).

7. Mbetje të volumit të madh

Mund të përfshijnë mobilje të vjetra, pajisje shtëpiake të hedhura, dyshekë etj. Këto zakonisht gjenerohen rastësisht dhe kërkojnë logjistikë të veçantë për mbledhje.

Bashkia Tropojë synon në planin 2025–2030:

- Ndarjen në burim të mbetjeve (organike, riciklueshme, inerte);

- Zvogëlimin e mbetjeve të përziera;
- Organizimin e fushatave të grumbullimit të veçantë për mbetje voluminoze, elektronike dhe të rrezikshme;
- Trajtim të veçantë për mbetjet bujqësore në zonat rurale.

Mbetjet nga industria minerare, pasurimit. Bashkia Tropojë ka qënë një qendër e rëndësishme industriale për një kohë të gjatë, pavarësisht ndryshimi i profilit ekonomik mbetjet industriale luajnë efektin negativë në mjedis. Aktualisht ky sektor është gjallëruar dhe disa

1 LIGJ Nr.10 463, datë 22.9.2011 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE “
 5. Personat fizikë a juridikë, të licencuar, që grumbullojnë ose transportojnë mbetje, dorëzojnë mbetjet e grumbulluara ose të transportuara në impiante trajtimi të përshtatshme që plotësojnë kërkesat e këtij ligji. 6. Të gjitha llojet e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen në baza profesionale nga një person te një tjetër, shoqërohen me një dokument transferimi. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm edhe në formë elektronike. 7. Dokumenti i transferimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e dokumentit të dorëzimit;

b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësisht të tjera kontakti transferuesit;

c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transferuesit; emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të personit, tek i cili transferohet mbetja (pritësi);

ç) informacion për sasinë dhe tipin e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen dhe tipin e kontenerëve në të cilët ndodhet;


d) vendin, kohën dhe datën e transferimit;

dh) përshkrimin e mbetjeve jo të rrezikshme bashkë me listën e kodeve respective;

kompani private, të cilat kanë investuar dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në shfrytëzimin e mineralit të, kromit, . Nga kjo industri si në të kaluarën edhe tani janë gjenerur e gjenerohen mbetje të ngurta në sasi të mëdha.

Territori i Bashkisë Tropojë është i pasur me burime minerare të ndryshme, të cilat përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal. Në shumë fshatra të kësaj bashkie janë identifikuar mineralizime me vlerë ekonomike, si kromi, bakri, ari, hekur-nikel, gurë ndërtimi etj.

Në vendburimet e kromit janë krijuar dampa të mëdha. Në ujrat që dalin nga galeritë e minierave Bytyc, Corraj Llugaj etj, janë me pH acid dhe ndotje të lartë. Edhe ujrat e tjera që drenojnë nga kjo zonë në fund shkarkohen në basenin e liqenit Fierzës dhe kanë impakt negativ në ujë dhe në llumrat fundorë të liqenit.]



4.8.1 Mbetjet në ujëra sipërfaqësor (plastika)

Bashkia Tropojë përfshin një territor të pasur me burime ujore natyrore, si lumenj, përrrenj dhe burime malore, ku ndër më kryesorët janë **lumi Valbona**, **lumi i Tropojës**, si dhe rrjedhat e tjera që derdhen në sistemin ujëmbledhës të Drinit të Bardhë. Gjatë stinës së pranverës, për shkak të rritjes së prurjeve ujore nga shkrirja e dëborës dhe reshjeve, në këto ujëra grumbullohen sasi të konsiderueshme **mbetjesh plastike dhe inerte**, të cilat transportohen kryesisht nga zona të banuara rurale dhe shtrati i lumit në territorin e bashkisë dhe përtej saj.

Një nga zonat më të prekura nga kjo ndotje është shtrati i **lumit Valbona** dhe degët e tij, ku shpesh mbetjet plastike, qese, shishe PET, mbetje shtëpiake dhe edhe goma makinash përfundojnë në ujë ose në brigje. Kjo ndotje ndodh si pasojë e **mungesës së pikave të organizuara për depozitimin e mbetjeve**, por edhe për shkak të **hedhjes së pakontrolluar** nga banorët apo vizitorët, sidomos gjatë sezonit turistik.

Në shumë raste, shtrati i lumenjve përdoret si kanal i rrjedhjes së **ujërave të zeza**, për shkak të mungesës së sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura në fshatrat dhe qendrat rurale të bashkisë. Situata përkeqësohet edhe nga **rrjedhja e mbetjeve bujqësore dhe mbeturinave të ndërtimit**, të cilat në mungesë të kontrollit përfundojnë në rrjedhat ujore.

Përceptimi mbi mbetjet është ende i ndryshëm në komunitet: për disa mbetjet janë vetëm një problem për t'u hedhur diku, ndërsa për të tjerë ato mund të shihen si një **burim potencial ekonomik**. Pikërisht për këtë arsye, Bashkia Tropojë ka nevojë të nxisë projekte që promovojnë

menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve, duke përfshirë komunitetin në ripërdorim, riciklim dhe ndarjen në burim të mbetjeve.

Zgjatja e jetës së mbetjeve përmes ekonomisë qarkulluese do të mundësonte:

- **Reduktimin e mbetjeve në mjedis dhe në landfill;**
- **Krijimin e vendeve të reja të punës, veçanërisht për grupet në nevojë;**
- **Zhvillimin e ekonomive të gjelbërta dhe vendore;**
- **Edukimin mjedisor të brezave të rinj dhe komunitetit;**
- **Krijimin e kushteve për një turizëm të pastër dhe të qëndrueshëm në zona si Valbona dhe Curraj i Epërm.**

Për të arritur këtë, nevojitet përmirësim i infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve, mbështetje për subjektet që merren me riciklimin, si dhe angazhim i institucioneve vendore në partneritet me komunitetin dhe aktorët privatë.

4.9 Problemet me menaxhimin e mbetjeve.

Menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Tropojë përballlet me një sërë sfidash strukturore, organizative dhe sociale që e bëjnë të vështirë realizimin e një sistemi të plotë dhe të qëndrueshëm të trajtimit të mbetjeve urbane dhe rurale. Më poshtë paraqiten problematikat kryesore:

1. Mungesa e infrastrukturës së duhur

- Shumë zona të banuara, sidomos në njësitë administrative malore dhe meshperndarje të madhe territoriale si fshatra si **Berishë, Bytyç, Lekbibaj, Tropoja fshat etj.**, nuk kanë **koshat e nevojshëm për grumbullimin e mbetjeve.**
- Ka mungesë të **pikave të përqendruara për depozitimin dhe stacioneve të transferimit të mbetjeve në zonat e largëta.**
- Infrastruktura rrugore në disa fshatra është e vështirë, gjë që e pengon **aksesin e mjeteve të pastrimit.**

2. Mungesa e ndarjes në burim dhe mungesë riciklimi

- Në të gjithë territorin e bashkisë **mbetjet nuk ndahen në burim**, gjë që pengon mundësinë e përpunimit dhe riciklimit të materialeve të ripërdorshme si plastika, letra, qelqi dhe metali.
- Aktualisht **nuk ka operatorë riciklimi të pranishëm fizikisht në zonë**, dhe mungojnë qendrat për grumbullim të materialeve të riciklueshme.

3. Dega e pastrimit me kapacitete të kufizuara

- Sektori i pastrimit në Bashki funksionon me **numër të kufizuar punonjësish**, të cilët nuk arrijnë të mbulojnë të gjitha zonat me frekuencë të nevojshme.
- **Mjetet dhe pajisjet** për pastrim janë të pakta, të amortizuara ose jo të përshtatshme për terrenin malor.

4. Ndotja nga mbetjet plastike dhe inerte

- **Lumenjtë dhe shtrati i tyre** përbëjnë një nga zonat më të ndotura, për shkak të derdhjes së mbetjeve plastike, inerte dhe organike nga zonat përreth.
- Mungesa e kontrollit dhe ndërgjegjësimit çon në **hedhje të pakontrolluar** të mbetjeve në mjedis të hapur, afër rrugëve, lumenjve dhe sipërfaqeve të gjelbra.

5. Ndërgjegjësim i ulët i komunitetit

- Një pjesë e popullsisë nuk është e ndërgjegjshme për ndikimin negativ të mbetjeve në mjedis dhe në shëndetin publik.
- Ka mungesë të **fushatave të vazhdueshme sensibilizuese** në shkolla, institucione publike dhe në komunitet.

6. Mungesë e një sistemi të qëndrueshëm financiar

- Pagesat për tarifën e pastrimit nga banorët janë shpesh të **pamjaftueshme për të përballuar koston reale të shërbimit**.
- Mungon një sistem i mirëmenaxhuar **monitorimi dhe penalizimi për ndotësit** apo për shkelësit e rregullave të depozitimit.

7. Ndotja e lumenjve dhe burimeve ujore

- **Lumi Valbona, lumi i Tropojës, lumi Gashi**, si dhe shumë përrenj të vegjël, janë të ndotur nga **hedhja e mbetjeve plastike dhe organike**, sidomos gjatë stinës së pranverës kur ka prurje të mëdha.
- Në disa fshatra, **ujërat e zeza** derdhen direkt në lumenj, për shkak të mungesës së kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit.
- Lumenjtë përballen me **mbetje inerte, goma makinash, qese plastike** dhe mbetje ndërtimi që transportohen nga reshjet ose hidhen në mënyrë të pakontrolluar nga banorët.
- Ndër zonat më problematike janë **shtrati i lumit Valbona pranë rrugëve turistike, lumi i Currajve**, si dhe rrjedhat në afërsi të **Bujanit, Shoshanit dhe Margegajt**.

Në territorin e Bashkisë Tropojë janë identifikuar disa venddepozitime mbetjesh me përmasa dhe funksione të ndryshme, të shpërndara në disa njësi administrative. Ato dallohen për nga **madhësia, kapaciteti, niveli i organizimit dhe ndikimi mjedisor**. Këto vendgrumbullime klasifikohen si më poshtë:

1. Venddepozitimi kryesor – Madhësi e madhe

- **Vendndodhja:** Afër qendrës së qytetit **Bajram Curri**, në **Kojë**.
- **Sipërfaqja:** Rreth **1.5 – 2 ha**.
- **Karakteristika:**
 - Është venddepozitimi më i madh në territorin e bashkisë.
 - Përdoret për hedhjen e mbetjeve të grumbulluara nga qyteti dhe fshatrat përreth.
 - Nuk është i pajisur me sistem inxhinierik (izolim, sistem kullimi, mbulim).
 - Ka ndikim të drejtpërdrejtë në ndotjen e mjedisit dhe ndodhet afër rrjedhave ujore.
 - Në afërsi të **lumit të Tropojës**.

2. Venddepozitime të mesme – Madhësi mesatare

Këto janë venddepozitime të përqendruara në disa qendra të njësive administrative, që shërbejnë për grumbullimin ditor ose periodik të mbetjeve.

	Fshati / Vendndodhja	Sipërfaqja e përafërt	Koment
Zona / Njësia Administrative			
Bytyç	Qafë Prush – afër rrugës	~0.6 ha	Depozitim jo i mbrojtur
Lekbibaj	Lagje e poshtme	~0.3 ha	Vend grumbullimi informa

3. Venddepozitime të vogla – Madhësi e vogël

Këto janë vende të pakontrolluara, spontane, të krijuara zakonisht nga banorët për shkarkim të mbetjeve shtëpiake ose inerte. Ato gjenden zakonisht pranë përrojeve, pyjeve apo në fund të rrugëve rurale.

Zona e ndotur	Tipi i mbetjeve	Komente
Shoshan	Mbetje urbane	Në hyrje të fshatit
Llugaj	Plastike dhe organike	Vend pa mbikëqyrje
Berishë	Inerte dhe mbetje shtëpiake	Hedhje afër rrugës
Curraj i Epërm	Kryesisht turistike	Mbetje të hedhura sezonale

- Vetëm një venddepozitim i përmasave të mëdha ka karakter më të qëndrueshëm funksional, por është gjithsesi pa standarde mjedisore.
- Pjesa më e madhe e mbetjeve depozitohen në mënyrë të pakontrolluar në pika spontane ose sipërfaqe të hapura nëpër fshatra.
- Kjo situatë përbën rrezik për ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, si dhe për shëndetin e banorëve dhe turizmin në zonat e mbrojtura.

Struktura përqindore e depozitimeve sipas llojit të burimit – Bashkia Tropojë






Tabela 3- Paraqitja grafike në përqindje e depozitimve e sipas llojit Burimi.

- Depozitimet sipas llojit në %



- Paraqitja grafike në përqindje e depozitimeve sipas llojit dhe madhësisë

Lloji i burimit	Sasia (ton)	Përqindja (%)
Shtëpiake	1200	44.4%
Komerciale	400	14.8%
Institucionale	150	5.6%
Bujqësore	100	3.7%
Ndërtimore / Inerte	600	22.2%
Turistike (sezoni veror)	250	9.3%



Vendosja e koshave të mbeturinave

Figura 5 - Shpërndarja e koshave të mbeturinave në Bashkinë Tropojë

Tabela e Zonave Urbane dhe Rurale në Bashkinë Tropojë – Menaxhimi i Mbetjeve

Zona (urbane/rurale)	Përshkrimi	Nr. PGM	Nr. Kontenierëve	Lloji i Shërbimit	Mjeti i përdorur	Skema e punonjësve	Frekuenca	Distanca në pikën fundore (km)
Urbane nr.1	Lagjet 1, 2, 3 – Qyteti Bajram Curri – 7,820 banorë	42	114	Çdo ditë, edhe grumbullim rrugor	Kamion 7.5 ton	1 shofer + 2 punëtorë	Çdo ditë	6 km
Urbane nr.2	Lagjet 4, 5, 6 – Qendra institucionale – 8,300 banorë	77	121	Çdo ditë	Kamion 9 ton	1 shofer + 2 punëtorë	Çdo ditë	7 km
Rurale nr.1	NJA Bujan – 3,500 banorë	60	51	Derë më derë dhe pika	Kamion 7.5 ton	1 shofer + 2 punëtorë	2 herë/javë	18 km
Rurale nr.2	NJA Margegaj – 6,200 banorë	50	90	Derë më derë dhe pika	Kamion 9 ton	1 shofer + 2 punëtorë	3 herë/javë	25 km
Rurale nr.3	NJA Tropojë e Vjetër – 5,400 banorë	40	78	Derë më derë dhe pika	Kamion 8 ton	1 shofer + 2 punëtorë	3 herë/javë	20 km
Rurale nr.4	NJA Lekbibaj – 3,200 banorë	—	46	Sezonal, me zetor privat	Zetor + 1 punëtor	1 shofer + 2 punëtorë	1 herë/javë	28 km
Rurale nr.5	NJA Llugaj – 1,200 banorë	15	—	Derë më derë dhe pika	Kamion 7.5 ton	1 shofer + 2 punëtorë	2 herë/javë	32 km
Rurale nr.6	NJA Fierzë – 1,300 banorë	16	—	Derë më derë dhe pika	Kamion 8 ton	1 shofer + 2 punëtorë	2 herë/javë	35 km
Totali	—	300	500	—	—	—	—	—

4.10 Shërbimi i pastrimit të rrugëve dhe shesheve

Shërbimi i pastrimit ofrohet plotësisht në:

1. **Qyteti i Bajram Currit**
 - Pastrim i përditshëm i rrugëve kryesore, shesheve dhe zonave përreth institucioneve.
 - Rrugët dytësore dhe lagjet periferike pastrohen me frekuencë më të ulët.
 - Disponohen punonjës të dedikuar dhe mjete pastruese.
2. **Njësia Administrative Bujan**
 - Ofrimi i pjesërisht të shërbimit, kryesisht në qendrat e banuara.
 - Pastrim manual nga punonjës vendorë, kryesisht në ditët e tregut ose ngjarje festive.
3. **Njësia Administrative Tropojë**
 - Shërbim i pjesshëm në qendrat e fshatrave.
 - Pastrim i rrugëve kryesore dhe shesheve pranë institucioneve publike.
4. **Njësia Administrative Margegaj**
 - Pastrim i rrugëve dhe shesheve në zonën e Valbonës dhe qendrës së njësisë.
 - Pjesërisht për shkak të aktivitetit turistik dhe fluksit sezonal.
5. **Njësia Administrative Lekbibaj**
 - Pastrim i pjesshëm, i fokusuar në qendrat e banuara dhe rrugët kryesore.

Shërbimi i pastrimit nuk ofrohet ose ofrohet shumë dobët në:

6. **Njësia Administrative Llugaj**
 - Mungesë e punonjësve të dedikuar për pastrim.
 - Rrugët dhe sheshet publike shpesh mbeten të papastruara.
7. **Njësia Administrative Bytyç (Berishë, Curraj i Epërm etj.)**
 - Vështirësi në terren për shkak të shpërndarjes së fshatrave dhe infrastrukturës së dobët.
 - Pastrimi bëhet rrallë dhe vetëm me angazhim vullnetar.
8. **Njësia Administrative Fierze**
 - Shërbimi është minimal ose nuk ofrohet rregullisht për shkak të distancës dhe mungesës së logjistikës.
 - Rrugët dhe sheshet nuk janë pjesë e itinerarit të rregullt të pastrimit.

5 ANALIZA E FINANCIARE E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Zëri i shpenzimeve	Shuma (lekë)
Paga të punonjësve	59008799
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore (afërsisht)	9000000
Mirëmbajtje e mjeteve dhe pjesë këmbimi	9511968
Karburante, vajra, bateri, goma etj.	53783030
Shpenzime të tjera (veshëmbathje etj.)	8059041
Totali	130362837

Figura 6- Analiza financiare e shërbimit të mjeteve.

6 RICIKLIMI DHE KOMPOSTIMI

Në territorin e **Bashkisë Tropojë** aktualisht **nuk regjistrohen aktivitete të strukturuar në lidhje me riciklimin dhe kompostimin**, si në qytet, ashtu edhe në njësitë administrative rurale.

Në qytetin e **Bajram Currit** është vendosur në disa zona një sistem me **3 kosha për ndarjen e mbetjeve**, ndërsa në zonat periferike dhe në fshatra praktikohet ende **sistemi me një kosh të vetëm**, ku mbetjet përzihen dhe transportohen drejt venddepozitimit.

Në të kaluarën janë zhvilluar përpjekje të fragmentuara për **grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme në shkolla**, veçanërisht në qytet, por këto iniciativa nuk kanë arritur në një sistem të qëndrueshëm. Përsëri, shkollat mbeten një burim potencial për **sensibilizim dhe edukim të brezit të ri** për ndarjen në burim dhe rëndësinë e riciklimit.

Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimit, si në nivel vendor ashtu edhe në rajonin e Tropojës, do të jetë një faktor kyç për zhvillimin e mëtejshëm të skemave lokale për riciklim. Aktualisht, **skema e grumbullimit të mbetjeve është klasike**, ku mbetjet përzihen dhe dërgohen në venddepozitim pa ndarje paraprake sipas fraksioneve (organike, plastike, letër, metal, etj.).

Edhe pse nuk ka një strukturë formale për riciklimin, **disa individë kryejnë grumbullim informal të mbetjeve të riciklueshme** (si plastika apo metali) nga Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve (PGM) apo nga depozitimet ilegale të mbetjeve. Ky aktivitet ndodh jashtë kontrollit të bashkisë dhe pa garanci për standardet mjedisore apo shëndetësore.

Detyrat prioritare të Bashkisë Tropojë në fushën e riciklimit dhe kompostimit janë:

1. **Krijimi i një skeme të qëndrueshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve** në qytet dhe gradualisht në zonat rurale.
2. **Edukimi dhe sensibilizimi i qytetarëve dhe nxënësve** mbi rëndësinë e ndarjes në burim dhe përfitimet e riciklimit.
3. **Nxitja e sektorit privat** për të investuar në infrastrukturën e riciklimit, duke krijuar marrëveshje bashkëpunimi.
4. **Promovimi i kompostimit** të mbetjeve organike, sidomos në zonat bujqësore si Bujan, Lekbibaj, Bytyç, etj., për të reduktuar mbetjet organike që përfundojnë në venddepozitim.
5. **Zhvillimi i partneriteteve publiko-private (PPP)** ose skemave të koncesionit për ndarjen, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve të riciklueshme.
6. **Identifikimi dhe përfshirja e bizneseve ekzistuese të riciklimit** që operojnë në rajon apo jashtë vendit, për të krijuar tregje dhe bashkëpunim për fraksionet e riciklueshme të mbetjeve.

Përfshirja e sektorit privat dhe partneritetet funksionale do të ndihmojnë në **zbutjen e barrës financiare të bashkisë** dhe do të garantojnë një zgjidhje të qëndrueshme nga pikëpamja **mjedisore, ekonomike dhe sociale**. Riciklimi dhe kompostimi mbeten komponentë kyç për përmirësimin e sistemit të përgjithshëm të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Tropojë.

6.1. Menaxhimi i Mbetjeve përmes Edukimit në Shkolla

Edukimi mjedisor, veçanërisht nëpërmjet sistemit arsimor, është një nga mjetet më efektive për të ndërtuar **një kulturë të qëndrueshme në menaxhimin e mbetjeve** në afat të gjatë. Shkollat kanë potencial të jashtëzakonshëm për të promovuar **ndarjen në burim, riciklimin, kompostimin, dhe zvogëlimin e ndotjes**, duke formuar që në moshë të hershme sjellje dhe qëndrime të përgjegjshme ndaj mjedisit.

Gjendja aktuale në Bashkinë Tropojë

- Aktualisht, **nuk ekziston një program i strukturuar edukimi mjedisor** i përqendruar në menaxhimin e mbetjeve në institucionet arsimore të bashkisë.
- Janë evidentuar **përpyjekje të pjesshme**, kryesisht në disa shkolla të qytetit të Bajram Currit, për të organizuar aktivitete sensibilizuese si ditë pastrimi, mbledhje simbolike e plastikës apo krijim postera.
- **Mungon infrastruktura** e nevojshme për ndarjen në burim brenda ambienteve shkollore (koshë të veçantë për letër, plastikë, mbetje organike, etj.).
- Nuk ka bashkëpunim sistematik ndërmjet **shkollave dhe operatorëve të pastrimit apo strukturave të bashkisë** për menaxhimin praktik të mbetjeve të gjeneruara në institucione.

Qëllimi dhe rëndësia

Edukimi për menaxhimin e mbetjeve në shkolla synon:

- Të ndërtojë **vetëdije të hershme** te nxënësit për ndikimin e mbetjeve në shëndet dhe mjedis.
- Të nxisë **sjellje të përgjegjshme** individuale dhe kolektive për ndarjen, riciklimin dhe zvogëlimin e mbetjeve.
- Të shërbejë si **model për komunitetin**, duke e kthyer shkollën në një pikë referimi për praktika mjedisore të mira.
- Të ndërthurë teorinë me praktikën përmes **projekt-mësimeve, aksioneve mjedisore dhe punëve në grup**.

Nr.	Masa/Veprimi	Përshkrimi
1	Hartimi i një programi mjedisor për shkollat	Në bashkëpunim me DAR Tropojë, për të përfshirë tema mbi ndarjen në burim, riciklimin, kompostimin dhe zvogëlimin e mbetjeve
2	Vendosja e koshave të ndarë në shkolla	Koshë për plastikë, letër dhe mbetje të tjera të riciklueshme në çdo institucion arsimor
3	Krijimi i komposteve të thjeshta në shkolla	Veçanërisht në shkolla të zonave rurale për mbetjet organike të oborrit apo mensës

4	Trajnime për mësuesit dhe nxënësit	Trajnime sezonale mbi edukimin mjedisor, të organizuara nga bashkia dhe organizata partnere
5	Aksione sensibilizuese të rregullta	Ditë të gjelbra, konkurse me temë “Shkolla ime riciklon”, pastrim simbolik i mjediseve publike
6	Bashkëpunim me biznese ricikluese	Marrëveshje për tërheqjen periodike të mbetjeve të riciklueshme nga shkollat
7	Ndërthurja e edukimit me aktivitete praktike	Si krijimi i posterëve, art nga mbetjet, vizita në venddepozitime, ose kompani të riciklimit

Masa dhe Veprime të Rekomanduara (2025–2030)

Rezultatet e pritshme

- Ngritje e vetëdijes mjedisore te brezi i ri në Tropojë.
- Reduktim i ndjeshëm i mbetjeve të përziera të prodhuara nga institucionet arsimore.
- Krijimi i një modeli bashkëpunimi ndërmjet bashkisë, shkollës dhe komunitetit.
- Rritje e përfshirjes së komunitetit në aktivitetet mjedisore përmes rolit udhëheqës të shkollës.
- Shtrirje graduale e kulturës së riciklimit në nivel familjar dhe komunitar.

6.2 Riciklimi si pjesë e rëndësishme e zgjidhjes

Bota ka ndryshuar shumë në shekullin e kaluar. Nga ushqimet e paketuara individualisht deri te pelenat e disponueshme, më shumë mbeturina gjenerohen tani se kurrë më parë.

Këto mbeturina, rryma e mbetjeve të ngurta, shkojnë më së shumti në vend-depozitime ku ngjeshen dhe groposen. Ndërsa rrjedha e mbetjeve vazhdon të rritet, po kështu do të jenë edhe presionet mbi deponitë tona, burimet tona dhe mjedisin tonë.

Sa më shumë të riciklojmë, aq më pak mbeturina rrjedhin në deponitë dhe impiantet tona të djegies. Duke ripërdorur aluminin, letrën, qelqin, plastikën dhe materiale të tjera, ne mund të kursejmë kostot e prodhimit dhe energjisë, si dhe të zvogëlojmë ndikimet negative që nxjerrja dhe përpunimi i materialeve ka në mjedis.

Gjithçka kthehet tek secili prej nesh. Riciklimi zbret në veprimin e një personi. Produkte të reja mund të bëhen nga mbetjet tuaja të riciklueshme. Riciklimi është i mirë për mjedisin tonë, komunitetet tona dhe ekonominë tonë.

6.3 Përfitimi nga riciklimi

Në një kuptim të gjerë, riciklimi është pjesë e një etike të efikasitetit të burimeve - të përdorimit të produkteve në potencialin e tyre të plotë. Kur një material i ricikluar, dhe jo një lëndë e parë, përdoret për të bërë një produkt të ri, burimet natyrore dhe energjia ruhen. Kjo për shkak se materialet e ricikluara tashmë janë rafinuar dhe përpunuar një herë; prodhimi për herë të dytë është shumë më i pastër dhe më pak energji intensiv se i pari. Prodhimi me kanaçe alumini të ricikluar përdor 95 për qind më pak energji sesa krijimi i të njëjtës sasi alumini nga minerali.

Investimet në grumbullimin e riciklimit mbështesin një industri të fortë dhe të larmishme të prodhimit të riciklimit, e cila sjell vende pune dhe paga të larta në zonat rurale. Mbledhja e materialeve të riciklueshme është hallka e parë më kritike në një zinxhir të aktivitetit ekonomik. Investimi në infrastrukturën vendore të grumbullimit paguan dividendë të mëdhenj në mbështetjen e aktivitetit të rëndësishëm ekonomik të riciklimit.

E rëndësishmja, shumë nga këta prodhues riciklimi mbështeten në një furnizim të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm të materialeve të riciklueshme të krijuara nga programet e riciklimit, prandaj është e nevojshme që të fillojë procesi në shkollë.

7. INDIKATORËT E PERFORMANCËS

Në përfundim të procesit për evidentimin e gjendjes ekzistues të shërbimit në Bashkinë Tropojë, u bë vlerësimi i performancës bazuar në indikatorët: i) Cilësia e shërbimit; ii) Qëndrueshmëria mjedisore; iii) Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare. Secili nga tre indikatorët ka indikatorët e tij specifikë, të cilët u përdorën për llogaritjen e indikatorit kryesor, siç shpjegohet më poshtë:

Cilësia e shërbimit - Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.

- a. **C1** Mbulimi i zonës me shërbim: ky indikator tregon sasinë e mbetjeve të grumbulluara në NJA nga firma private e autorizuar ose nga njësia vetë (nëse e kryen ajo shërbimin) kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në njësi:

$$C1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që gjenerohen në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

- b. **C2:** Pastërtia e bashkisë: ky është një indikator gjithëpërfshirës, i cili vlerësohet nga tre kritere vlerësimi:

- i. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve (prezenca e mbetjeve të akumuara rreth PGM);
- j. Efektiviteti i pastrimit të rrugëve (prezenca e mbetjeve në rrugë);
- k. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve në zonat e largëta (prezenca e mbetjeve të akumuara/pika ilegale/ djegie të mbetjeve në rrugë).

- c. **C3:** Shkalla e kënaqësisë publike: ky është një indikator cilësor për shërbimin që ofron bashkia, dhe vlerësohet në sajë të pyetësorëve të ndryshëm me komunitetin. Zakonisht ky indikator llogaritet në sajë të një pyetje të vetme: **A jeni të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve që ofrohet në njësinë tuaj?**

Për vlerësimin e këtij indikator i kanë shërbyer fushatat e pyetësorëve dhe dëgjesta publike të zhvilluara nga bashkia

Qëndrueshmëria mjedisore – Ky indikator përbëhet nga dy indikatorë specifikë.

- a. **D1:** Shkalla e grumbullimit të diferencuar: ky indikator prezanton shkallën e sasisë të mbetjeve që grumbullohen të ndara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet si më poshtë:

$$D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen të ndara në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

- b. **D2:** Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave: ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohen në impiante të autorizuar. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet si më poshtë:

$$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që trajtohen në impiante } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare: Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.

- a. **E1** - Mbulimi i Kostos: ky indikator mat sa kosto e plotë e shërbimit e mbuluar nga grumbullimi i tarifave. Formula më poshtë tregon se llogaritet ky indikator:

$$E1 = \frac{\text{Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Kosto totale e shërbimit } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$


- b. **E2** - Shkalla e mbledhjes së tarifës: ky indikator reflekton kapacitetin e popullsisë për të paguar tarifën. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet në formulën më poshtë:

$$E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga tarifa e pastrimit } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Totali i të ardhurave të planifikuara } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

- c. **E3** - Transparenca në systemin e faturimit: ky është një indikator cilësor, i cili ka tre shkallë vlerësimi:
- i. I ulët: nuk ka një sistem faturimi për tarifën e pastrimit
 - ii. Mesatar: ka një sistem faturimi dhe konsumatori merr një faturë
 - iii. I lartë: ka një sistem faturimi dhe konsumatori ka informacion dhe kupton tarifën e llogaritjes dhe mënyra e llogaritjes është e qartë dhe transparente për të gjithë komunitetin

Më poshte jepen rezultat e vlerësimit të gjendjes ekzistuese sipas indikatorëve të performancës në Bashkinë Tropojë:

Indikatorët		Shprehja aktuale në bashkinë Tropojë
Indikatori 1	Niveli i mbulimit të zonës me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve mbulon qytetin e Bajram Currit dhe pjesërisht njësitë administrative rurale. Në disa zona periferike dhe fshatra të thellë shërbimi ofrohet rrallë ose mungon krejtësisht. Mbulimi i përgjithshëm përllëgaritet të jetë rreth 65–70% e territorit të bashkisë.
Indikatori 2	Shkalla e grumbullimit të ndarë të mbetjeve sipas kategorive të veçanta	Në Bashkinë Tropojë nuk kryhet ndarje në burim apo grumbullim i ndarë i mbetjeve sipas kategorive (plastikë, letër, organike, metal, qelq). Mbetjet grumbullohen dhe transportohen në mënyrë të përzier. Niveli i ndarjes është 0% .
Indikatori 3	Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave (në impiante sanitare ose venddepozitime të kontrolluara)	Të gjitha mbetjet e grumbulluara në Tropojë depozitohen në venddepozitimin e kontrolluar në Koj , i cili është i regjistruar dhe menaxhohet nga bashkia. 100% e mbetjeve të mbledhura shkojnë në këtë venddepozitim.
Indikatori 4	Mbulimi i kostos së shërbimit nga realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit	Të ardhurat nga tarifa e pastrimit mbulojnë pjesërisht koston reale të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Bashkia subvencionon një pjesë të shpenzimeve me fonde nga buxheti vendor. Mbulimi i kostos vlerësohet të jetë nën 50% .
Indikatori 5	Niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit kundrejt planifikimit nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve	Niveli i arkëtimit të tarifës së pastrimit është i ulët , sidomos në zonat rurale dhe për subjektet private. Ka mospërputhje midis planifikimit dhe realizimit. Vlerësohet se vetëm 40–50% e të ardhurave të planifikuara arkëtohen realisht . Kjo ndikon në mungesë fondesh për përmirësimin e shërbimit.



8 PLANIFIKIMI I MEMANXHIMIT TË MBETJEVE

8.1 Objektivat

1. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi **100%**i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025 – 2030.
2. Zgjerimi i shërbimit në **100%**në zonën urbane dhe **90%**në zonën rurale gjatë periudhës 2025 – 2030.
3. Rishikimi i taksës së pastrimit dhe ndarja e saj nga taksa gjelbërimit dhe ndriçim.
4. Realizimin e ndërtimit dhe funksionimin e landfillit deri në vitin 2027 nga një kompani franceze me fondet e BE-se, e cila do të mundësojë edhe infrastrukturën në terren për ndarjen e mbetjeve në burim dhe mbylljen e ciklit.
5. Me realizimin e këtyre do të synojmë rritjen e shërbimit në masën 80% deri në vitin 2030 në zonat rurale dhe në zonat urbane dhe përmisimin e infrastrukturës të grumbullimit, kontenierë dhe mjete teknologjike

8.2 Skenarët e ofrimit të shërbimit

Skenari bazë

1. Grumbullim i mbetjeve miks në **100%**të zonës urbane (çdo ditë në javë) dhe **40%**zonës rurale (2 herë në javë)
2. Transportim i tyre me mjete teknologjike
3. Depozitimi i tyre në fushën e depozitimit në Tropojë, në dalje të qytetit

Ky është skenari bazë që Bashkia Tropojë po aplikon aktualisht.

Skenari I

1. Grumbullimi i mbetjeve (zona urbane **100%**dhe **70%**zona rurale): Të zgjeroj shërbimin e pastrimit në njësitë administrative si: NJA Bytyç, NJA Tropoë, NJA Bujan, NJA Lekbibaj për vitet 2025-2030 me të paktën një herë në javë me 70% të këtyre njësive. Paisjen me dy kosha për PGM në këto njësi. Në njësitë që mbulon me shërbim aktualisht ta rrisim shërbimin në dy herë në javë. Në NJA Margegaj,, NJA Lekbibaj,, NJA Tropojë në ditën e hënë dhe të enjte.
2. Transportim i tyre me mjete teknologjike
3. Depozitimi **100%**të sasisë së mbetjeve drejt në landfillin në Tropojë
4. Identifikimi dhe eliminimi i grumbullimeve ilegale në të gjithë teritorrin e Bashkisë

Skenari II

1. Grumbullimi i mbetjeve (zona urbane **100%**dhe **90%**zona rurale) - Me shtimin e stafit dhe koshave zgjerim të shërbimit si dhe rritje të cilësisë së infrastrukturës për të hedhur hapa për bashkëpunim me banorët për të parë mundësinë e ndarjes në burim.
2. Grumbullimi i diferencuar me **2 kosha në 3 zona pilote të qytetit/** grumbullim i diferencuar për bizneset
3. Transportimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme dhe mbetjeve mix (në TS dhe qendra për rikuperimin e materialeve)
4. Transporti për nëlandfillin në Tropojë
5. Organizimi i infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të rrymave të tjera.

9 PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

9.1 Vizioni

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Tropojë u formëzua në sajë të një procesi të vazhdueshëm diskutimi dhe konsultimi midis palëve të interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit (Grupi i Punës, grupi i ekspertëve konsulentë dhe Bashki te Forta), në sajë të analizimit gjendjes ekzsituase të ofrimit të shërbimit dhe propozimeve për konsolidimin e shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë.

Referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve, prioriteteve të përgjithshme dhe konkrete si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, dhe ruajtjes së burimeve natyrore u ra dakord që vizioni i bashkisë të jetë:

“Sigurimi i menaxhimit të integruar dhe të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta bashkiake në të gjithë rajonin, më qëllim reduktimin e ndikimit negativ në mjedis dhe shëndetin e njeriut dhe në përdorimin efektiv të burimeve natyrore, për të nxitur rritjen sociale dhe ekonomike dhe maksimizimin e mundësive në të gjithë rajonin në përputhje me kuadrin ligjor, institucional dhe teknik”

9.2 Objektivat

Bashkia Tropojë gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit lokal për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve për venddepozitim. Më tej ajo kërkon të fillojë të zbatojë skema për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane, duke synuar mbylljen e ciklit të plotë të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ky plan ka parashikuar hartimin e objektivave si më poshtë:

1. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi **100%** i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025 – 2030.
2. Zgjerimi i shërbimit në **100%** në zonën urbane dhe **70%** në zonën rurale gjatë periudhës 2025 – 2030.
3. Rritja e shkallës së grumbullimit të diferencuar në masën **10%** dhe pilotimi i sistemit të grumbullimit të diferencuar me dy kosha (të riciklueshme të thata dhe të tjera) për banorët në 1 zonë të qytetit përgjatë periudhës 2025-2030.
4. Rritja e mbulimit të kostos operacionale me **5%** çdo vit, gjatë periudhës 2025-2030.
5. Rritja e shkallës së grumbullimit të tarifës në masën **25.4%** për bizneset, **4.7%** për banorët dhe **15.5%** për institucionet përgjatë periudhës 2025-2030.

9.3 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Sipas legjislacionit në fuqi, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake (urbane) për të cilën Bashkia Tropojë është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse:

Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.), dhe
- Mbetje të veçanta urbane (mbetje ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy rryma:

- Mbetjet e gjeneruara nga familjet (MF)
- Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe industritë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane

Ndërkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen ‘mbetje të veçanta’ për të cilat njësia vendore duhet t’i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

9.4 Grumbullimi, transporti i mbetjeve

Në parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve Bashkia duhet të marrë në konsideratë parimin për parandalimin e ndotjes. Cilësia dhe koston e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, përdorin PGM, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për manaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullaror në sajë të:

- Hartimit të një rregulloreje vendore për manaxhimin e mbetjeve, ku do të përcaktohen procedurat, protokollet e punës, parashikimet se çfarë do të ndodh në rast avarish apo aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe gjobat përkatëse në rast të shkeljeve të evidentuara. Si parakusht, bashkia duhet të caktojë një grup pune për monitorimin dhe për të vënë në zbatim këto rregulla;
- Parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe derdhjen e mbetjeve jashtë kontenierëve gjë që duhet të sjellë në vëmendje rëndësinë kryesore që kanë fushatat e ndërgjegjësimit dhe programet e edukimit;
- Marrëveshje me konsumatorët e mëdhenj, për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë, ku rekomandohet vendosja e orareve në ditë dhe orë të caktuara për dorëzimin e mbetjeve nga konsumatori në pikat e caktuara nga bashkia, ose grumbullimi i tyre nga bashkia, në sajë të një kontrate të veçantë, në pikat e gjenerimit të tyre.

Ndërkohë elemente të tjerë që kanë të bëjnë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, që bashkia duhet të marrë në konsideratë gjatë planifikimit të shërbimit në territorin e saj, janë si më poshtë:

- Orare pune efektive dhe të përshtatshme: Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të hartojë një program efektiv dhe të përshtatshëm pune. Ky program duhet të marrë parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e banorëve dhe veprimtarive tregtare.
- Numri i duhur i kontenierëve: Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të sigurojë numrin e duhur të kontenierëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve.

- Itenerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve: Përcaktimi i saktë i itenerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston duke pakësuar forcat që shpenzohen për mbledhjen e mbetjeve. Rekomandohet verifikimi i përputhshmërisë me parimet e efektshmërisë së itenerarit të grumbullimit të mbetjeve si dhe të kohës efektive me metodën (MTM – Metodës të Matjes së Kohës).
- Rritja e rendimentit në punë: Bashkia apo kompanitë private duhet të gjejnë mekanizma për të përmirësuar punën duke rritur rendimentin. Masat që mund të ndërmerren për të rritur moralin, përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniforme, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në grup.
- Mirëmbajtja e përshtatshme e kontenierëve dhe makinave të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve: Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve janë çështje të rëndësishme për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga bashkia apo kontraktohet një kompani private, bashkia duhet të përcaktojë ose parashikojë në kontratë mirëmbajtjen e duhur dhe standardet e riparimit që duhet të vihen në zbatim.

Referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar në qytetin e Tropojës është më mirë se në zonat rurale. Megjithatë Bashkia është e motivuar dhe e angazhuar të përmirësojë këtë situatë duke synuar si përmirësimin e nivelit aktual të ofrimit të shërbimit në lidhje me cilësinë, efikasitetin dhe efektshmërinë, por gjithë Tropojëtu të krijojë një bazë të qëndrueshme mbi të cilën do të mbështeten iniciativat lokale dhe rajonale për minimizimin e mbetjeve. Për bashkinë është shumë e rëndësishme, jo vetëm konsolidimi i shërbimit dhe diversifikimi i tyre në NJA Tropojë apo në qendrat urbane të njësive të tjera administrative, por edhe në rritjen e cilësisë në zonat rurale të njësive të tjera administrative.

Duke kaluar në një përjasje teknike, ekzistojnë mënyra të ndryshme për grumbullimin, ruajtjen dhe transportin e mbetjeve në funksion të kategorive të konsumatorëve dhe tipologjisë urbane të zonave të banuara. Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, bashkia është përgjegjëse për të mbledhur vetëm “mbetjet urbane”, sipas përcaktimeve të dokumentave ligjorë dhe të këtij plani. Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje (përbërje) nga mbetjet urbane nuk pranohen nga sistemi i bashkiak për grumbullimin e mbetjeve.

Për disa mbetje të ashtuquajtura “të veçanta” që prodhohen nga banorët mund të organizohen metoda për grumbullimin e tyre në mënyrë të diferencuar nga sistemi publik (bazë) bashkiak. Ekzistojnë kufizime të tjera për përdorimin e sistemit bazë bashkiak të grumbullimit të mbetjeve që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore (Neni 12 i Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996), konsumatorët jo-banorë që prodhojnë mbi $\frac{1}{4}$ e sasisë që mund të hidhet në një kontenier mbetjesh (zakonisht

1.1m3) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për grumbullimin e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash.

Në lidhje me përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e skemës së përbashkët për grumbullimin e mbetjeve, duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë sipas formulës të llogaritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe qëllimit për mbulimin e të gjithë territorit të bashkisë më shërbim, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme: kontenierë dhe makina teknologjike. Si fillim u përcaktua kapaciteti i përshtatshëm i kontenierëve si dhe frekuenca e dëshirueshme e shërbimit. Kontenierët me volum 1.1m3, plastik për qytetin e Tropojë dhe metalik për njësitë e tjera administrative, rekomandohen si më të përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve në këtë bashki. Ndërkohë bazuar në sasinë e mbetjeve të gjeneruara, frekuencës të ofrimit të shërbimit, dhe eksperiencës të ofrimit të shërbimit në Bashkinë Tropojë, për territorin e saj Bashkia preferon mjete teknologjike 10ton dhe 5ton, dhe vetëm në rrugica të ngushta në qytet dhe në rrugët e ngushta të zonave rurale, përdorimin e mjeteve teknologjike 5 ton apo kamioncinave. Në figurën më poshtë tregohet skematikisht skema e përgjithshme e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në territorin Bashkisë Tropojë:

9.5 Manaxhimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore

Sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e mbetjeve (VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”) është përgjegjësia e prodhuesit (familje, biznes apo industri) që të largojë dhe transportojë mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet), ndërtimore apo voluminoze që mund të gjenerojë nga aktiviteti që kryen për në vendet e përcaktuara nga pushteti vendor për këtë qëllim. Ndonëse ekziston ky kuadër ligjor, i cili përcakton mjaft mirë detyrat për secilin aktor të përfshirë në këtë fushatë, asnjë nga bashkitë e vendit nuk ka përcaktuar një vend për depozitimin e mbetjeve inerte.

Në kuadrin ligjor theksohet se këto vende të përcaktuara për depozitimin e mbetjeve inerte/ndërtimore/voluminoze duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të posaçme dhe duhet të pranojnë vetëm këto lloj mbetjesh, dhe jo përzierje apo përpunime të këtyre mbetjeve me elemente të tjerë, pasi ato mund të jenë të rrezikshme.

Të gjitha venddepozitimet e mbetjeve inerte kanë të njëjtën mënyrë operimi si landfillet për mbetjet urbane, ku gjeneruesi i mbetjeve duhet të paguajë një tarifë kundrejt sasisë së mbetjeve inerte që transportohet, e cila mbulon koston e operimit të fushës, trajtimit të tyre dhe mbylljen përfundimtare të saj. Ndërkohë ndalohet ndërtimi i venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:

- Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor;
- Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;
- Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën e parë.

Landfillët e mbetjeve inerte mund të jenë landfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose landfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit, ku do të ndërtohet landfili rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në landfille dhe venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë.

Në mënyrë të veçantë, ka një treg ripërdorimi për agregatet që rrjedhin nga mbetjet e ndërtimeve në rrugë, kanalizime dhe projekte të tjera ndërtimi. Nëse nuk ndahen që në burim apo nuk transportohen veçmas, ato mund të përmbajnë sasi të vogla të mbetjeve të rrezikshme, përzierja e të cilave mund të paraqesë rrezik të veçantë për mjedisin dhe mund të pengojë riciklimin.

8. SKENARËT E MUNDSHËM NE MENAXHIMIN E MBETJEVE

Skenari bazë

4. Grumbullim i mbetjeve miks në 100% të zonës urbane dhe 50% zonës rurale
5. Transportim i tyre me mjete teknologjike të amortizuar.
6. Depozitimi i tyre në fusha depozitimi, pranë lumenjëve apo jashtë çdo lloj kontrolli

Skenari I


5. Grumbullimi i mbetjeve (zona urbane 100% dhe 90% zona rurale)
6. Transportimi me mjete teknologjike dhe ndërtimi i qendrave të transferimit (qendra për rikuperimin e materialeve).
7. Depozitimi 100% të sasisë së mbetjeve në venddepozitime të kontrolluara
8. Identifikimi dhe eliminimi i grumbullimeve ilegale në të gjithë teritorrin e Bashkisë.

Bashkia Tropojë parashikon ofirimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve me një frekuencë 7 ditë në javë në zonë urbane, dy herë në ditë në këto orare: i) Gjatë periudhës së dimrit (turni i parë në orën 11:00 dhe turni i dytë në orën 19:00); ii) Gjatë periudhës të stinës së verës (turni i parë në orën 10:00 dhe turni i dytë në orën 22:00).

Në zonën rurale shërbimi ofrohet 4-5 herë në javë.

Bashkia Tropojë do të ndjekë skenarin I .

Zona	Tipi	Pop. e shërbyer	Gjenerim (kg/dite)	Kamion	Ton	Distanca (km)	Frekuenca	Kosto O&M (Lekë)	Kosto Investimi (Lekë)
Zona 1	Qyteti Bajram Curri	16,621	0.7	1	9 ton	7	7	7,928,441	6,480,466
Zona 2	Lagje periferike	9,004	0.7	1	8.5 ton	7	7	4,973,008	5,885,453
Zona 3	NJA Bujan	3,487	0.3	1	8 ton	26	2	5,087,031	4,374,584
Zona 4	NJA Llugaj, Margegaj	8,299	0.3	1	8 ton	20	2	3,999,865	3,891,504
Zona 5	NJA Lekbibaj	4,698	0.3	1	7.5 ton	30	2	4,386,605	3,504,674
Zona 6	NJA Tropojë, Berishë	5,593	0.3	1	8 ton	25	1	4,487,638	4,373,440
Zona 7	NJA Bytyç, Kojë	3,794	0.3	1	8 ton	30	1	4,532,698	4,253,322



9. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

11.1 Rregullorja vendore

Bashkia e Tropojë duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren lokale për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku të përcaktohet qartë rolin dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

1. Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;
2. Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve;
3. Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;
4. Marrjen e masave parandaluese për mosdjegien e mbetjeve në kazanë, për moshedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia;
5. Marrjen e masave parandaluese për moshedhjen e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, mosdepozitimin e kafshëve të ngordhura dhe mbetjeve të rrezikshme në PGM të mbetjeve urbane;
6. Shmangien e parkimit të automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
7. Marrjen e masave për pastrimin nga ana e pronarëve të hapësirave rreth dyqaneve dhe pikave ambulatorie të shitjes;
8. Marrjen e masave për sigurimin e një pastërtie të pranueshme duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugorë të depozitimit të mbetjeve;
9. Mbajtja e uniformave gjatë proceseve të punës nga punonjësit e pastrimit;

10. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve):

- Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
- Procedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
- Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
- Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
- Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
- Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
- Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet

- Parandalimi i problemeve për Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve);
- Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
- Procedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
- Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
- Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
- Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
- Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
- Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet;
- Parandalimi i problemeve për shëndetin publik.

1. Zbatimi dhe sanksionet

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan”, ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për dekurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

Gjjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve.

12 . NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në nivele të kërkuara në territorin e bashkisë, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. Suksesi i çdo skeme menaxhimi mbetjesh bazohet plotësisht nga mbështetja e përdoruesve.

Konsumatorët si familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushatë të fortë ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të grumbullimit, duke zbatuar kërkesat e hedhjes dhe ndarjes së mbetjeve dhe duke penguar materialet e padëshirueshme (psh. mbetjet e rrezikshme), të hyjnë në rrymën e mbetjeve të grumbulluara. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe nivelit të pastërtisë, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar për bashkinë Tropojë, lidhur me infrastrukturën apo depozitimin e sigurtë të mbetjeve. Ka disa mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbetjeve dhe për

të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektive për arritjen e objektivit.

Hartimi i një plani ndërgjegjësimi do të mundësojë: I) ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së territorit dhe koston e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve; II) ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore; III) nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metoda për komunikimin dhe informimin: Metodën më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkollë. Një zhvillim i lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesin në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të re) mund të jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe të koston e ulët si edhe shpejtësisë që ofron. Gjithashtu mund të shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme (festa, tubime, koncerte), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informimi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë.

Në programet e riciklimit apo minimizimit të mbetjeve metoda më e mirë është ajo “derë më derë”. Kjo metodë fton konsumatorët në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret. Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, kompostohen dhe mënyrën se si ato duhet të veprojnë për t’u bërë pjesë e procesit.

Përdorimi i makinave teknologjike që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve apo kontenerët për informim: Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenerët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme një slogane domethënëse për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

Marrja e opinionëve të qytetarëve: Një tjetër çështje e rëndësishme është krijimi i mekanizmave për marrjen e mendimeve dhe reagimit të qytetarëve: si mund të ftohet publiku t’i japë bashkisë mendime apo opinionë ose komente për shërbimin e mbetjeve. Dy metodat kryesore për të marrë mendimin e publikut janë:

- Mundësia e publikut për t’u ankuar: Bashkia apo operatori i shërbimit duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacioni për të marrë ankesat. Numri i ankesave dhe zgjidhja e tyre është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve.
- Vlerësimi i kërkesës dhe sondazhi/studimi i “vullnetit për të paguar”: Për të vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë për të paguar, lind nevoja për të komunikuar me

përfituesit e mundshëm të shërbimit lidhur me alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin dhe tarifat. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t'u përfshirë në sondazh, kampionet që duhet të realizohen duhet të variojnë midis 100 dhe 200 të intervistuar. Kjo praktikë duhet të kryhet periodikisht nga bashkia, ose sa herë ajo e shikon të arsyeshme për të marrë opinionin e publikut në lidhje me vlerësimin e performancës të shërbimit.

12.1 Fushata e informimit në Bashkinë Tropojë gjatë hartimit të planit

Bashkia duhet të promovojë në komunitet apo në zonat pilot, ide dhe mënyra të reja për manaxhimin e mbetjeve, si prezantimi i skemave të reja për grumbullimin e mbetjeve (në burim), ndarjen e mbetjeve, ripërdorimi i mbetjeve, metodat alternative të dorëzimit të mbetjeve, etj., duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, të fokusuara për disa konsumatorë apo në një zonë pilot.

Synimi për këtë fazë është t'i informojë komunitetin se është marrë një vendim për aplikimin e një skeme të re; apo se ekziston një mënyrë tjetër më e preferueshme për manaxhimin e mbetjeve në kraTropojëim me mënyrën tradicionale; dhe se ekzistojnë arsye të mira për të ndërmarrë një ndryshim në praktikatat aktuale të manaxhimit të mbetjeve. Shpërndarja e këtij informacioni në publik duhet të vijë jo vetëm si një vendim i marrë në nivel bashkie, por edhe në formën e një kërkesë (me anë të një pyetësori, i cili do të vlerësojë nevojat e komunitetit dhe mendimi që ka komuniteti për aplikimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve).

Nisur nga ky fakt, bashkia mund të fillojë fushatën e ndërgjegjësimit me anë të një pyetësori, i cili mund të përsëritet periodikisht (1-2 herë në vit), për të vlerësuar si fillim opinionin e tyre në lidhje me gjendjen ekzistuese të manaxhimit të mbetjeve dhe prezantimit të metodave të reja të manaxhimit të mbetjeve, si ndarja në burim, riciklimi, kompostimi i mbetjeve. Në këtë pyetësor do të parashikohet edhe një pjesë në lidhje me opinionin/sjelljen e banorëve kundrejt tarifës së mbetjeve, a janë ata të informuar në lidhje me shërbimet të cilat ata paguajnë, mendimi i tyre në lidhje me propozimin e tarifave të reja për mbetjet etj.

Metodat më të preferuara të ndërgjegjësimit publik, të cilat mund të përdoren nga bashkia si fazë fillestare e ndërgjegjësimit të komunitetit për manaxhimin e mbetjeve është metoda derë më derë duke përfshirë vullnetarë apo studentë të interesuar të bëhen pjesë e fushatave aktive.

Një një fazë të dytë, komuniteti që tashmë është informuar dhe ndërgjegjësuar për çështjet e manaxhimit të mbetjeve, si dhe për idetë apo programet e reja, do të kërkojë informacione të tjera shitesë, ose do të jetë në pritje për të kërkuar informacione shitesë, përderisa bashkia do të vendosë që të zbatojë këto skema të manaxhimit të mbetjeve në territorin që ajo administron. Qëllimi është që t'i bëjnë ata më shumë me dije psh. për praktikatat e kompostimit dhe riciklimit të mbetjeve ose për praktikatat e ndarjes së mbetjeve. Pas përcaktimit të zonave ku do të zbatohen skemat e ndarjes në burim (riciklim apo kompostim), bashkia duhet të fillojë të

hartojë një program të detajuar, i cili duhet të ketë si qëllim jo vetëm informimin e komunitetit në lidhje me iniciativat e reja që janë ndërmarrë për manaxhimin e mbetjeve, por edhe konkretisht ku do të konsistojnë, infrastruktura e nevojshme, cili do të jetë roli i tyre në këto iniciativa, përfitimet konkrete që ata do të kenë, niveli i tarifave dhe metodat nxitëse financiare etj.

Kjo fazë e rritjes së interesit do të propozojë konkretisht hapat që do të ndjekë bashkia për të realizuar këtë fushatë ndërgjegjësimi, ku do të parashikohet të organizohen takime, seminare, vizita në terren, në impiantet e mbetjeve apo të riciklimit, etj., me pjesëmarrjen e individëve dhe grupeve të interesit duke përfshirë profesionistë dhe manaxherë të mbetjeve.

Vlerësimi dhe përmirësimi, në këtë fazë, drejtuesit e programeve të bashkisë duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë programin dhe rezultatet e tij çdo 3 muaj, për të parë nëse programi është realizuar sipas parashikimeve, nëse ka rezultuar i suksesshëm, i përshtatshëm dhe financiarisht i përballueshëm për të përmbushur mjaftueshmërisht pritshmëritë dhe objektivat. Falë vlerësimit mund të përmirësohen aktivitetet, grafikët ose rrugët e operimit, të merren vendime nëse do të vazhdohet me programin, apo të merren vendime për përmirësimin dhe mbështetjen e tij etj. Nga ana tjetër, autoritetet vendore synojnë të përfshijnë njerëzit më pranë programit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre.

Ky vlerësim mund të zhvillohet në fund të çdo fushate aktive (1 herë në muaj ose 1 herë në 3 muaj), ku njësia vendore përcakton disa forma të kontrollit si më poshtë:

- Vlerësim vizual në zonat, të cilat kanë filluar të zbatojnë skemat e reja të manaxhimit të mbetjeve;
- Vlerësim sasior, në lidhje me sasinë e mbetjeve të cilat janë reduktuar nga rryma e përgjithshme e mbetjeve (pra kanë shkuar për riciklim apo kompostim);
- Vlerësim cilësor i zonave në të cilat janë vendosur infrastruktura të posaçme për trajtimin e mbetjeve, si kosha për riciklim apo për kompostimin e mbetjeve, nëse ato janë funksionale apo jo dhe nëse janë të mirëmbajtura apo jo;
- Vlerësim i opinionit të qytetarëve, kryesisht të atyre të cilët kanë filluar zbatimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve me anë të një pyetësori të shkurtër, i cili duhet të nxjerrë në pah:

- ✚ A është e përshatshme skema për qytetarët;
- ✚ A janë ata të ndërgjegjësuar dhe informuar mjaftueshëm për operimin e suksesshëm të skemës;
- ✚ Sistemi i aplikuar i tarifave a justifikon mjaftueshëm skemën e re të manaxhimit të mbetjeve etj.

Gjatë kësaj faze, si bashkia ashtu edhe konsumatorët do të kërkojnë prova të qëndrueshmërisë nga partneriteti i tyre i deritanishëm, me qëllim që palët të sigurohen se kontributi i gjithësecilit ka vlerë dhe se pala tjetër tregon përkushtimin e duhur. Në këtë fazë

rekomandohen intervistat, takimet publike dhe seminarët për të treguar rezultatet dhe për të prezantuar hapat për të ardhmen.

Informimi për Sistemin e ri të tarifave: Bashkia me fillimin e aplikimit të skemave të reja do të fillojnë të aplikojnë edhe një sistem të ri të tarifave të mbetjeve, për një shërbim i cili do të ofrohet në një territor më të madh, ku në disa raste nuk ekzistonte më parë. Si fillim bashkia duhet të përcaktojë tarifën e mbetjeve dhe procesi i vendosjes së tarifës së mbetjeve duhet të kalojë në 9 hapa kryesorë, të cilat duhet të jenë pjesë e fushatës ndërgjegjëse për tarifën e mbetjeve:

1. Njohja me konsumatorët – bashkia duhet të identifikojë kategoritë dhe numrin e konsumatorëve që gjenerojnë mbetje në territorin e saj. Ky informacion duhet të paraqitet në broshurat informuese.
2. Sasia e mbetjeve që gjenerohen në bashki – Pasi janë përcaktuar kategoritë dhe numri i konsumatorëve, bashkia duhet të përcaktojë edhe sasinë e mbetjeve që gjenerohen në territorin e saj (sipas kategorive) dhe normat e gjenerimit të mbetjeve për kategoritë e konsumatorëve. Ky informacion që duhet të paraqitet në broshurat informuese do t'i japë mundësi konsumatorëve që të kuptojnë realisht sasinë e mbetjeve që gjenerohen në njësinë e tyre dhe sa e rëndësishme është pagesa e tarifës për të siguruar menaxhimin e tyre.
3. Vlerësimi i opsioneve teknike – Skema e re do të parashikojë edhe aspekte të reja teknike për mënyrën e ofrimit të shërbimit. Ky informacion, në lidhje me aspektet e reja teknike të shërbimit (nr. i kontenerëve, lloji i tyre për mbetjet miks apo të diferencuara, numri i makina për transport, stabilimentet për depozitimin e mbetjeve etj) duhet t'i vihet në dispozicion komunitetit, që ai të kuptojë realisht teknologjinë e ofrimit të shërbimit të ri.
4. Vendosja e marrëdhënies institucionale – Komuniteti duhet të njihet me ndarjen e përgjegjësisë dhe detyrave në skemën e re të ofrimit të shërbimit të mbetjeve. Cila do të jetë përgjegjësia dhe roli i secilit territor administrativ në skemën e re të menaxhimit të mbetjeve? Në këtë mënyrë ai do të kuptojë edhe dinamikën përkatëse në territorin ku ai ndodhet.
5. Njohja me koston e ofrimit të shërbimit – Për të vendosur tarifa sa më afër realitetit duhet të përcaktojmë koston e plotë të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve sipas shërbimeve që do të ofrohen: i) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve; ii) fshirjen dhe larjen e rrugëve; iii) trajtimin e ndërmjetëm të mbetjeve; iv) trajtimin final të mbetjeve; v) kostot operative; vi) kostot kapitale; vii) kostot indirekte etj. Në këtë mënyrë komuniteti e ka më të qartë koston e shërbimeve që ai do të marrë.
6. Identifikimi i burimit të të ardhurave – Komuniteti duhet të njihet edhe me burimet financiare të cilat do të sigurojnë ofrimin e shërbimit sipas standardeve.
7. Përzgjedhja e niveleve të duhura për tarifën dhe llogaritja e tyre – Pasi bashkia ka përcaktuar numrin dhe kategoritë e konsumatorëve, kostot e shërbimit dhe burimet e të ardhura, ajo ka mundësinë që të përcaktojë edhe nivelet e duhura të tarifave për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Ky informacion është mëse i rëndësishëm

për t'u ndarë me konsumatorët, ku ata njihen specifikisht se për cilat shërbime, me një kosto të caktuar, ata do të paguajnë.

8. Vendimmarrja strategjike – Në sajë të karakteristikave të njësive vendore merren disa vendime strategjike për vendosjen e nivelit të tarifave për kategoritë e konsumatorëve, ku përcaktohet sa përqind e kostos pritet që të mbulohet nga mbledhja e tarifave.

Komunikimi i sistemit të ri të tarifave – bashkia mund të përcaktojë mënyrën më të mirë për informimin e publikut në lidhje me 8 hapat më lart, të cilat mund të realizohen me anë të takimeve periodike, stendave në hyrje të bashkisë apo edhe me broshura informuese, ku japin rezultatet e 8 hapave më lart.

Nisur nga ky fakt, bashkia do të duhet të fillojë një fushatë ndërgjegjësimi për sistemin e ri të tarifave për mbetjet, e cila do të prekë qytetarët në dy nivele: i) ata që e paguanin më parë tashmë tani do të kenë një sistem të ri; ii) ata të cilët nuk kanë patur shërbim do t'u duhet së pari të njihen dhe të kuptojnë se si funksionon sistemi, ku ata do të bëhen pjesë dhe më pas të fillojnë të paguajnë.

Në fushatën ndërgjegjëse dhe informuese për sistemin e tarifave, e cila do të jetë pjesë e fushatës për promovimin e skemës së re ndërvendore, bashkia duhet të marrë në konsideratë këto parime:

- Alokimin eficient të burimeve që ka në dispozicion bashkia;
- Ofrimi në mënyrë sa më eficiente të shërbimit - krijimi i incentivave për të ofruar shërbimin me kosto sa më të ulët;
- Përdorimi eficient i burimeve natyrore - përmbushja e objektivave mjedisore, si promovimi i skemave të riciklimit dhe kompostimit;
- Mbulimi i kostos – tarifat e vendosura duhet të reflektojnë të gjitha shërbimet që kryhen për shërbimin e manaxhimit të mbetjeve;
- Qëndrueshmëria financiare – tarifat e vendosura duhet të reflektojnë një qëndrueshmëri të sistemit të manaxhimit të mbetjeve;
- Barazi horizontale mes përdoruesve, të cilët duhet të paguajnë të njëjtën shumë për të njëjtin nivel shërbimi të ofruar;
- Zbatimi i parimit “Ndotësi Pague”;;
- Parimi i “Proporcionalitetit” – sasia e tarifës duhet të reflektojë sasinë e shërbimit të ofruar;
- Parimi i “Transparencës” – vendosja e tarifës duhet të jetë e qartë dhe nëse ka incentiva ato duhet të qartësohen për komunitetin

13. PLAN VEPRIMI

13.1 Komponenti: Kuadri ligjor dhe institucional

1	Objektivi Strategjik		Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
1.	Përgatitja e kuadrit ligjor dhe rregullator lokal të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat në nivel kombëtar	1.1	Miratimi i Planit Lokal të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Ngurta Bashkiake;	Bashkia Tropojë; Këshilli Bashkiak	2025-2030
		1.1	Përditësimi i Rregullores	Bashkia Tropojë (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik)	2025-2030
		.2	Lokale të Manaxhimit të Mbetjeve në kushtet e ndarjes së re administrative;	Konsulentë të jashtëm & Ekspertë; Këshilli Bashkiak	
		1.1	Aprovimi i sanksioneve lokale dhe penalteteve për çështjet e mbetjeve;	Bashkia Tropojë, (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik, Drejtoria e manaxhimit financiar)	2025-2030
		.3		Këshilli i Bashkiak	
		1.1	Aplikimi i instrumentave të komunikimit dhe informimit të komunitetit rreth rregullave dhe penalteteve;	Bashkia Tropojë, (Përgjegjësi i Shërbimeve), Vullnetarët, OJF, përfaqësues të komunitetit,	2025-2030
1.	Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi dhe depozitimi pa kriter i mbetjeve të rrezikshme (si dhe spitalore) në zbatim të legjislacionit shqiptar	1.2	Informimi i komunitetit për të diferencuar mbetjet e rrezikshme nga mbetjet urbane si dhe detyrimet e tjera të prodhuesit të mbetjeve;	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve), Shkollat, ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2025-2030
		1.2	Krijimi i skemave efektive për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të rrezikshme (të ngjashme me skemat e redukimit të mbetjeve);	Bashkia Tropojë, (Përgjegjësi i Shërbimeve); ARM, ISHMPU, ISHS	2025-2030
		.2		Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	
		1.2	Ruajtja e sigurtë në mënyrë të përkohshme e mbetjeve të rrezikshme (sipas rregullores për administrimin e tyre) derisa të sigurohet një zgjidhje rajonale apo kombëtare për trajtimin përfundimtar të tyre.	Bashkia Tropojë, (Drejt. Shërbimeve publike) ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2025-2030
1.	Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi i mbetjeve spitalore apo	1.3	Inspektimi dhe kontrolli i ndotjes urbane nga materialet inerte dhe ndërtimore, skeletet e makinave, etj, që nga	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve &	2025-2030

mbetjeve inerte dhe ndërtimore		gjenerimi, transporti deri depozitimin e tyre;	inspektorët bashkiakë), ISHMPU; Kompanitë e ndërtimit	
	1.3	Projektim dhe ndërtim ose miratim të një venddepozitimi të përkohshëm për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore brenda standarteve kombëtare;	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Këshilli i Bashkiak	2025-2030
	1.3	Organizimi i tryezave lokale me industrinë e ndërtimit për të inkurajuar përdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve;	Bashkia Tropojë (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Industria e ndërtimit	2025-2030
	1.3	Hartimi i një rregullore për operimin e venddepozitimit për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore. Përcaktimi i sanksioneve kundrejt gjeneruesve të mbetjeve në rast të mos menaxhimit të duhur të këtyre mbetjeve që ata gjenerojnë;	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Këshilli i Bashkiak	2025-2030
	1.3	Monitorimi i rregullt i operimit të venddepozitimit të mbetjeve ndërtimore dhe vëllimore, si dhe monitorimi i prodhuesve të tyre në lidhje me procedurën që ata ndjekin kur gjenerojnë këto lloj mbetjesh.	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve, Përgjegjësi i venddepozitimit të mbetjeve ndërtimore dhe voluminoze)	2025-2030
1.4 Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij	1.4	Krijimi i dhe miratimi i një strukture lokale të inspektorëve bashkiak në lidhje me mjedisin dhe mbetjet;	Bashkia Tropojë; Këshilli Bashkiak	2025-2030
	1.4	Zbatimi i sistemit të monitorimit në të gjitha NJA të Bashkisë dhe aplikimi i sanksioneve kundrejt shkelësve të rregullave apo dëmtuesve;	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë);	2025-2030
	1.4	Përmirësimi i procedurave të licencimit mjedisor të ST në kooperim të ngushtë me strukturat e Agjensisë	Bashkia Tropojë ; ARM; ISHMPU	2025
	1.3			

	Rajonale të Mjedisit (ARM) dhe ISHMPU;		
1.4	Koordinimi në nivel rajonal	Bashkia Tropojë; Keshilli i	2025-
.4	dhe me njësitë lokale fqinje për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet, apo organizimin e shërbimit apo përdorimit e përbashkët të infrastrukturës së mbetjeve;	Qarkut Tropojë, si dhe njësitë e tjera locale	2030

13.2 Komponenti: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve dhe Pastrimi i Rugëve

2	Objekti	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
2.1	Objekti Strategjik Përmirësimi i shërbimeve të mbetjeve në Bashkinë Shkodër; Ofrimi i shërbimeve eficientë dhe cilësorë;			
	2.1.1	Riorganizimi i zonave të shërbimit të mbetjeve (ndarje e Bashkisë në tre zona shërbimi;	Bashkia Tropojë; (Kryetari, z. Kryetari Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve)	2025-2030
	2.1.2	Hartimi i dokumnetave të tenderit për tre kontrata e reja, sipas tre zonave në të cilat do të ofrohet shërbimi. Hapja e tenderit, për zgjedhja e kompanive që do të ofrojnë shërbimin;	Bashkia Tropojë; (Kryetari, z. Kryetari Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve, Ekspertë të jashtëm, Zyra Jurike);	2025-2030
	2.1.3	Shtrirja e shërbimit në NJA në të cilat nuk ofrohet shërbimi i mbetjeve dhe konsolidimi i shërbimit në NJA të cilat kanë patur shërbim. Investim në infrastrukturë duke e përmirësuar atë, në sajë të nevojës të reja që ka Bashkia (blerje kontenerësh dhe mjete teknologjike;	Bashkia Tropojë; (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra juridike dhe financave);	2025-2030
	2.1.4	Monitorimi i rregullt i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në të tre zonat e mbetjeve (tre kontrata e shërbimit). Raportime të rregullta nga të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e monitorimit në instancat vendimmarrëse të bashkisë. Përgatitja e raporteve ditore/javore dhe mujore të gjendjes së PGM për të gjitha NJA;	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2025-2030
	2.1.5	Prezantimi i skemave të ndarjes në burim në rrugët kryesore të qytetit dhe në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit (mbetje të njoma dhe të thata);	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2025-2030
	2.1.6	Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme. Investim në kontenerë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve;	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra juridike dhe e financave, kompanitë private);	2025-2030
	2.1.7	Projektimi dhe ndërtimi i një pike grumbullimi për mbetjet e riciklueshme, e cila do të shërbejë për të pritur dhe paketuar mbetjet që vijnë nga zonat pilot	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë,	2025-2030

	të grumbullimit të ndarë të mbetjeve në qytetin e Shkodrës;	kompanitë private, Këshilli Bashkiak);	
2.1.8	Prezantimi i skemave të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme në NJA Rrethinat dhe NJA	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2026-2030
2.1.9	Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të biodegradueshme. Investim në kontenierë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve;	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra juridike dhe e financave, kompanitë private);	2026-2030
2.1.10	Projektimi dhe ndërtimi i dy pikave të hapura për kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme dhe kontrolli i vazhdueshmë i këtyre pikave;	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private, Këshilli Bashkiak);	2025-2030
2.1.11	Me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit të bëhen transparent për publikun kostot e shërbimeve të pastrimit sipas kontratave si dhe detyrimet, ndalimet, rregullat si dhe një informacion specifik rreth shërbimeve, orareve, iniciativave, etj.	Bashkia Tropojë, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private).	2025-2030

13.3 Komponenti: Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve

3	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
3.1	Rehabilitimi i të gjitha vend depozitimeve të vjetra në të gjitha NJA të Bashkisë Tropojë	3.1.1 Kryerja e një studimi fizibiliteti për rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve në NJA; 3.1.2 Sigurimi i financimit për zbatimin e projektit të rehabilitimit; 3.1.3 Rehabilitimi i venddepozitimeve në NJA (sipas projektit); 3.1.4 Hartimi dhe miratimi i një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes.	Bashkia Tropojë; (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm Bashkia Tropojë (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm Bashkia Tropojë; (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm Bashkia Tropojë (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030
3.2	Monitorimi i vazhdueshëm i venddepozitimit	3.2.1 Lobim institucional pranë qeverisë qendrore (MIE&MTM) për financimin e projektit të ndertimit të një landfilli 3.2.2 Monitorimi i rregullt i të gjitha dërgesave të mbetjeve që hyjnë në landfill, kontrolli i ngarkesës në lidhje me kategorinë e mbetjeve që duhet të lejohet të hyjë në landfill, raportimi i rregullt i ngarkesave të mbetjeve që hyjnë në venddepozitim	Bashkia Tropojë Bashkia Tropojë; (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike,	2025-2030 2025-2030

13.4 Komponenti: Ndarja dhe Riciklimi i mbetjeve

4	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët tjerë	Afatet kohore
4.1	Promovim i i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema të përshtatshme pilot; Progresi drejt objektivave kombëtarë për minimizimin e mbetjeve në nivel lokal.	4.1.1 Mobilizimi i përfshirjes së komunitetit në skemat pilot, bërja e anketimeve paraprake për vlerësimin e vullnetit për t'u përfshirë para se të përzgjidhen zonat e dëshiruara; 4.1.2 Hartimi i një plani-pune specifik për zbatimin e skemave të ndarjes së mbetjeve, i cili duhet të koordinohet me sistemin ekzistues të grumbullimit të mbetjeve të tjera urbane; 4.1.3 Krijimi dhe zbatimi i skemave pilot të riciklimit dhe kompostimit të shtëpi sipas skemave pilot të rekomanduara në këtë plan; 4.1.4 Organizimi i takimeve në komunitet dhe me biznese, para dhe gjatë fillimit të skemave pilot për të mbështetur përpjekjet/programet e ndërgjegjësimit dhe edukimit për rritur cilësinë dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit; 4.1.5 Organizimi i takimeve me grupet e interesit në rajon dhe me gjerë. Reklamimi i faciliteteve ricikluese si dhe skemave të grumbullimit të diferencuar, skemave të kompostimit; 4.1.6 Monitorimi i zbatimit të skemave të ndarjes së mbetjeve, riciklimit dhe kompostimit: efektivitetit dhe cilësisë së funksionimit ashtu dhe sasisë së mbetjeve që ndahet dhe përpunohet; Mbajtja e një regjistri javor për këto të dhëna dhe relatimi çdo muaj pranë grupit mbikqyrës në bashki; 4.1.7 Lidhja e marrvëshjeve bashkëpunimi/pjesëmarrje me bizneset e mëdhenj ashtu dhe nëse është e mundur me komunitetin e skemave pilot për detyrimet dhe përfitimet e palëve; 4.1.8 Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe analiza ekonomike mbi zhvillimin lokal të kompostimit në nivel lokal ose ndër-lokal.	Bashkia Tropojë, OJF, Komuniteti, vullnetarë, Bashkia Tropojë, (Përgjegjësi i shërbimeve, ekspertë të jashtëm Bashkia, Tropojë Ekspertë& Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti Bashkia Tropojë , Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti Bashkia Tropojë, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Shoqata e Bashkive Bashkia Tropojë , Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit Bashkia Tropojë Ekspertë, bizneset e mëdhenj të qytetit, konsumatorët e skemave pilot Bashkia Tropojë, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm;	2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030
4.2	Stimulimi dhe mbështetja e	4.2.1 Inkurajimi i shtrirjes së skemave të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi përmes bashkë-financimit me bizneset e riciklimit dhe komunitetin;	Bashkia Tropojë, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2025-2030

sektorit privat lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe komposti mit	4.2.2	Promovimi dhe zhvillimi i tregjeve lokale për materialet e riciklueshme.	Bashkia Tropojë , Ekspertë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2025- 2030
---	-------	---	--	---------------

13.5 Komponenti: Aspektet Financiare					
5	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara		Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
5.1	Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, marrvës hjeve dhe kontrata ve; Krijimi një sistemi finaciar të përmirësuar (lidhur me buxhetin, investime t e nevojsh me)	5.1. 1	Aplikimi çdo vit i metodologjisë së "Llogaritjes së plotë të kostos sipas modelit të DLDP " kur shpenzimet kapitale vlerësohen dhe llogaritet përgjatë gjithë jetës së dobishme të makinave dhe kontenierëve;	Bashkia Tropojë (Përgje. Shërbimesh, dhe Dep. për Manaxhimin dhe Hartimin e Programeve Financiare-DMHPF)	2025-2030
		5.1. 2	Rritje progresive e buxhetit vjetor operacional+mirëmbajtjes drejt mbulimit total të kostove operacionale dhe kostos kapitale;	Bashkia Tropojë (Përgj Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak	2025-2030
		5.1. 3	Kompesime financiare për konsumatorët me pamundësi për të paguar (me asistencë sociale apo me të ardhurave të ulëta) dhe jo për grumbullim inefficent të tarifave;	Bashkia Tropojë (Përgj Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak	2025-2030
		5.1. 4	Hartimi i projekteve konkrete dhe të kërkohe mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, hua nga institucione financiare apo banka;	Bashkia Tropojë Këshilli Bashkiak	2025-2030
		5.1. 5	Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total;	Bashkia Tropojë (Policia Urbane, Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2025-2030
		5.1. 7	Aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mos pagimin e tarifave të mbetjeve;	Bashkia Tropojë (Policia Urbane, Insp. Shërbimesh, Këshilli Bashkiak	2025-2030
		5.1. 8	Vendos stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Aplikimi i uljeve në tarifat dhe heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit;	Bashkia Tropojë (Përgjegj. Shërbimesh, Këshilli Bashkiak	2025-2030
		5.1. 9	Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan";	Bashkia Tropojë (Përgj. Shërbimesh,, Këshilli Bashkiak	2025-2030
		5.1. 10	Kryerja e studimeve periodike (vjetore) mbi "Dëshirën për të paguar" dhe "Mundësinë për të paguar" nga qytetarët;	Bashkia Tropojë (Dep.MHPF, Përgj. Shërbimeve), , Vullnetarë	2025-2030
		5.1. 11	Rishikimi i strategjisë së mbulimit të kostove dhe nivelit të tarifave, bazuar në analizën e zhvilluar në plan dhe marrja në konsideratë e performancës së grumbullimit, studimin e dëshirës për të paguar, kostove dhe objektive si dhe	Bashkia Tropojë (Dep.MHPF, Insp. Shërbimeve) Ekspertë të jashtëm	2025-2030

indikatorët financiar të përcaktuar në këtë plan;

- | | | | |
|--------|---|--|-----------|
| 5.1.12 | Transparenca dhe komunikimi: Procesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke përdorur metodat e komunikimit në masë si dhe atë "derë më derë". | Bashkia Tropojë (Dep.MHPF, Përgj Shërbimeve), , Vullnetarë, OJQ | 2025-2030 |
|--------|---|--|-----------|

13.6 Komponenti: Ndërgjegjësimi Publik dhe Edukimi

6	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
6.1	Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të territorit, pagimin e tarifës së pastrimit, si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve	6.1.1 Ofrimi i vazhdueshëm i informacioneve të përgjithshme për publikun dhe bizneset; broshura informative, buletinë, postera, rrjete sociale, etj; 6.1.2 Ofrimi i informacioneve specifike për grupet e interesit (konsumatorët në zonat pilot); 6.1.3 Lançimi i nismave të reja (grumbullimi individual i mbetjeve, riciklimi dhe kompostimi) duke përdorur promovimin në TV, radio lokale dhe gazeta; 6.1.4 Krijimi i grupeve në komunitet për promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin në zonat pilot dhe konsumatorët pilot; 6.1.5 Hartimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit sipas grupeve të interesit (qytetarët, bizneset, shkollat, industria, etj); 6.1.6 Përdorimi i mjeteve teknologjike dhe kontenierët për të ofruar informacion të përgjithshëm (slogan, numrat e kontaktit, grafikët e shërbimit); 6.1.7 Realizimi i fushatës "derë më derë" për të përfshirë popullatën dhe bizneset në mënyrë eficiente mbi aktivitetet e riciklimit dhe ndarjes në burim dhe pagesës së tarifës së pastrimit; 6.1.8 Hartimi i programeve dhe fushatave "vijuese" të riciklimit	Bashkia Tropojë; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, Bashkia Tropojë; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, Bashkia Tropojë; Bizneset e riciklimit, Bashkia Tropojë; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, Bashkia Tropojë; Komuniteti, Bizneset e riciklimit, Bashkia Tropojë ; Bashkia Tropojë ; Bizneset e riciklimit, Vullnetarë, Bashkia Tropojë ; Konsulentë &	2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030 2025-2030

	për të përmirësuar cilësinë e ndarjes në burim përmes programeve të riciklimit;	Ekspertë të jashtëm, Bizneset e riciklimit, Vulnetarë,	
6.1.9	Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët.	Bashkia Tropojë; Konsulentë &Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit,	2025-2030

14. RISHIKIMI I PLANIT

Ndjekja e zbatimit të planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike (çdo 5 vjet) ose më shpesh nëse është e nevojshme për vlerësimin dhe rishikimin e objektivave dhe masave. Monitorimi dhe vlerësimi mund të funksionojë si një bazë për rishikimin e planit.

Çështje të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë kur të analizohet ky plan janë sigurisht vlerësimi nëse objektivat janë përmbushur, nëse masat e parashikuara kanë qenë efektive apo jo. Një plan duhet të rishikohet gjithashtu, kur politika kombëtare e mbetjeve rekomandon apo detyron ndryshime thelbësore në mënyrën e manaxhimit të mbetjeve apo vendos objektiva të ndryshëm në funksion të obligimeve ndërkombëtare. Në këto raste, plani duhet të përballë me ndryshime të thella ose mund të jetë i nevojshëm hartimi i një plani të ri. Përgjatë zbatimit të planit, duhen analizuar në mënyrë të vazhdueshme faktorët kryesorë që impaktojnë në parashikimet dhe objektivat e vëna në plan, si zhvillimi i popullsisë, ndryshimet lidhur me konsumin dhe llojin e mbetjeve të gjeneruara nga industritë apo ekonomitë shtëpiake. Gjithashtu analizimi i këtyre faktorëve shërben për të vlerësuar programet dhe projektet në proces apo që priten të fillojnë.

14.1 Monitorimi

Ky plan duhet të parashikojë hapat në vazhdim, indikatorët dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse objektivat janë përmbushur dhe të raportimin tek vendimmarrësit. Qëllimi është që të sigurojë që autoritetet përgjegjëse u është dhënë mundësia për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe të vendosin mbi masat shtesë, nëse është e nevojshme. Studimi bazë, i kryer për qëllim të këtij plani, do të shërbejë si një status bazë mbi të cilën do të vlerësohen arritjet e objektivave dhe targeteve dhe mbi të cilat do të matet ndryshimi i indikatorëve të performancës së planit.

Monitorimi i planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike dhe, nëse është e nevojshme mund të kërkojë rishikimin e objektivave dhe masave të planit. Monitorimi i planit do të shërbejë për:

1. Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit, mbi statusin e zbatimit të planit;
2. Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;
3. Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo të efektshme;
4. Për të mësuar, përditësuar dhe shpërndarë informacion dhe njohuri.

14.2 Si kryhet monitorimi dhe vlerësimi

Bashkia duhet të ndjekë këto hapa në kryerjen e procesit të monitorimit dhe të vlerësimit të planit, si më poshtë:

1. Rishikimi i situatës: Rishikimi i objektivave dhe synimeve, kontrolli nëse ato i përshkruajnë kontekstin real dhe vlerësimi i tyre me anë të indikatorëve;
2. Mbledhja e evidencave sasiore dhe cilësore që lidhen me mbetjet;
3. Analizimi i evidencave: Analizimi i të dhënave për të matur progresin, krahasimi i rezultateve me objektivat dhe synimet, kontrolli nëse objektivat janë arritur në një afat kohor të dëshiruar;
4. Dokumentimi i konkluzioneve
5. Ndarja dhe diskutimi i konkluzioneve: Gjetjet duhet të ndahen me palët e interesuara dhe domosdoshmërisht me vendimmarrësit.

Kryetari i bashkisë duhet të ngarkojë një grup pune përgjegjës apo zyrtarë të caktuar, brenda stafit të bashkisë, me përgjegjësinë e monitorimit dhe vlerësimit të planit. Grupi i punës duhet të përfshijë zyrtarë të administrimit të mbetjeve, administrimi financiar, struktura të mjedisit dhe kontrollit të territorit dhe konsulentëve të jashtëm.

